



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.04.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 1 dhe 2 prill 2019
2. Seancë dëgjimore për raportimin e Autoritetit për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për veprimtarinë e vitit 2018
3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për strategjinë e edukimit ligjor të publikut në Republikën e Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Vasilika Hysi, bashkim Fino, Edmond Leka, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Edlira Bode dhe Adelina Rista

Mungojnë:

Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Damian Gjiknuri, Alket Hyseni, dhe Tom Doshi

Të ftuar:

Gentiana Sula-Kryetare e Autoritetit për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Skënder Vrioni- Sekretar i Përgjithshëm i Autoritetit për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Simon Mirkaj- anëtar i Autoritetit për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Marenglen Kasmi- anëtar i Autoritetit për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Altin Hoxha- anëtar i Autoritetit për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Bianka Hada- sekretare e Kryetares së Autoritetit për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Ornela Arapi- përfaqësuese nga Drejtoria e Edukimit Qytetar në Autoritetin për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

Mirela Lame- përfaqësuese nga Drejtoria Juridike e Edukimit Qytetar në Autoritetin për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme. Kuorumi është i plotësuar për të vazhduar me tri çështjet që kemi sot në rendin e ditës. Çështja e parë është miratimi i procesverbaleve të datave 1 dhe 2 prill 2019. Çështja e dytë është seancë dëgjimore për raportimin e Autoritetit për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për veprimtarinë e vitit 2018 dhe çështja e tretë e rendit të ditës është shqyrtimi i projektvendimit “Për strategjinë e edukimit ligjor të publikut në Republikën e Shqipërisë”, si një nga tri projektligjet e fundit të paketës së dytë të reformës në drejtësi.

Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës. A ka sugjerime apo vërejtje për procesverbalet? Nuk ka.

Miratohen procesverbalet e Komisionit të Ligjeve për datat 1 dhe 2 prill të vitit 2019.

Vazhdojmë me seancën dëgjimore për raportimin e Autoritetit për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për veprimtarinë e vitit 2018. Komisioni ynë është komision përgjegjës, relatorë janë zonja Xhina dhe zoti Shameti. Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Autoriteti për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit zonja Gentiana Sula, kryetare, mirë se keni ardhur zonja Sula, zoti Skender Vrioni, sekretar i Përgjithshëm, si dhe anëtarët: zoti Simon Mirakaj, zoti Marenglen Kasmi dhe zoti Altin Hoxha. Mirë se keni ardhur! Nuk po prezantoj pjesën tjetër, sepse shoh që sot është prezent i gjithë stafi i Autoritetit, të cilët e kanë vlerësuar këtë raportim.

Pa humbur kohë do t’ia kaloj fjalën zonjës Sula për të bërë një prezantim të shkurtër të veprimtarisë së Autoritetit që ajo drejton për vitin 2018. Pastaj fjalën e kanë relatorët dhe pyetje0përgjigje nga kolegët.

Fjala për ju, zonja Sula.

Gentiana Sula – I nderuar, kryetar,

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ligjeve,

Ju falënderojmë për ftesën dhe mundësinë që na dhatë për të treguar jo vetëm sukseset, por edhe sfidat tona në zbatimin e ligjit nr. 45\2015 “Për të drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”. Ju e prezantuat pjesëmarrjen tonë dhe duke qenë se institucioni është i ri, kompleks dhe ka fusha veprimi të shkrira në një, ne kemi menduar se mund të ketë pyetje teknike nga anëtarët e komisionit. Kështu që kemi prezent edhe disa drejtues të karakterit teknik, të cilët mund të shuajnë kuriozitetin dhe t’u japin përgjigje pyetjeve më specifike.

Ju e keni përpara raportin vjetor, të cilin e kemi publikuar dhe u është vënë në dispozicion të gjithëve. Do të bëj një parashtrësë në pikat kryesore, ku ka konsistuar puna jonë dhe ku synojmë ta çojmë për vitin 2019 e më tej.

Institucioni ynë është i krijuar në frymën e rezolutës 1481 të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës, që titullohet “Domosdoshmëria për dënimin ndërkombëtar të krimeve të regjimeve totalitare komuniste”, e vitit 2006. Sot kanë 80 vjet nga fillimi i Luftës së Dytë Botërore, 80-vjetori i rezistencës antifashiste, 75 vjet nga çlirimi i vendit dhe 30 vjet nga rënia e komunizmit në mbarë Europën Lindore. Ky është konteksti që na frymëzon për të parë sesi mund të çohet më tej fryma e pajtimit dhe bashkëpunimit në mbrojtje të të drejtave të njeriut, dinjitetit të tij, lirisë, demokracisë, barazisë para ligjit dhe shtetit të së drejtës.

Autoriteti ka hyrë në vitin e tretë të funksionimit, ku mundëson ushtrimin e së drejtës së çdo të interesuari për t’u informuar për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Ky ka qenë një vit me përpjekje dhe me rezultate. Kemi marrë shumë vendime, jemi mbledhur 68 herë si Autoritet dhe kemi marrë 482 vendime; kemi verifikuar 463 kandidatë apo zyrtarë të lartë, u jemi përgjigjur 184 kërkesave për qëllime rehabilitimi dhe dëmshpërblimi; kemi përpunuar dhe u kemi dhënë përgjigje 612 aplikimeve individuale, 172 kërkesave institucionale, studimore dhe mediatike, ku vëmë re që numri është shumë i lartë dhe i jep shumë theks misionit tonë, i cili është kaq i nevojshëm për të bërë një rishqyrtim të historisë dhe për të bërë edukim qytetar. Pra, janë 172 studiues, gazetarë, që ulen çdo ditë, duke shfrytëzuar dhjetëra mijëra faqe materiale, që u janë vënë në dispozicion. Nga të gjitha këto janë deklasifikuar 33700 fletë dokumente arkivore dhe janë vënë në dispozicion 82150 faqe. Kërkesat kanë ardhur në rritje të konsiderueshme, po ashtu aktivitetet e institucionit janë rritur.

Vëmendja jonë është fokusuar në tri drejtime kryesore:

Së pari, aksesimi i çdo qytetari në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.

Së dyti, vlerësimi i cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve dhe zyrtarëve përpara emërimit apo ngritjes në detyrë, sipas kërkesave të institucioneve kushtetuese.

Së treti, krijimi i infrastrukturës së duhur për mundësimin e kërkimit shkencor dhe informimin e medias.

Lidhur me fushën e arkivës, ju e dini që ne po krijojmë një arkivë të vetme me të gjitha dokumentet e ish-Sigurimit.

Në funksion të realizimit të detyrimeve kemi marrë në dispozicion 2,2 kilometër dokumente, ku rreth 70% e tyre përbëjnë sekret shtetëror. Kemi ndërtuar të gjithë infrastrukturën tonë të brendshme për administrimin, ruajtjen dhe qarkullimin sipas ligjit për

informacionin e klasifikuar dhe akteve të tjera nënligjore që lidhen me këtë fushë veprimi. I gjithë stafi është i pajisur me certifikatë sigurie për të ruajtur sa më mirë interesin kombëtar, që gjithsesi gjendet në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, ku duhet verifikuar dhe analizuar rast pas rasti.

Kemi marrë dokumente arkivore nga Arkiva Qendrore, nga Arkiva e Shërbimit Informativ të Shtetit, e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrinë së Punëve të Brendshme. Fizikisht vazhdojnë të jenë në institucionet ku ndodhen dhe kemi vështirësi serioze për të bërë transaksione të përditshme, për të mbledhur materiale, duke u pajisur me të gjitha rregullat e qarkullimit të materialeve, qoftë edhe sekrete, procesverbale, shoqërimi me dy anëtarë të Autoritetit, ku shpeshherë vëmë në pikëpyetje pavarësinë e institucionit tonë, duke qenë se ne përdorim ende disa institucione të tjera për të magazinuar arkivën tonë.

Lidhur me fushën e Informimit, kemi një fluks të punës në rritje. Sot që flasim vijmë çdo ditë e më shumë qytetarë dhe institucione, të cilët bëjnë verifikime. Numri i zyrtarëve të verifikuar është 1300, që është numër i kënaqshëm, por jo i mjaftueshëm. E theksoj që kërkesa e medieve dhe e qytetarëve është në rritje. Për sa kohë këtë vit vihet në funksion ligji i vetingut të policisë, ne presim një angazhim të madh, ndoshta edhe 10-fishim të punës së autoritetit dhe rritje të madhe të fluksit të punës sa i përket verifikimit të figurave dhe cilësive etiko-profesionale morale,

Lidhur me fushën e kërkimit shkencor dhe edukimit qytetar kemi një strategji gjithëpërfshirëse komunikimi, që është fokusuar tek ish të përndjekurit, familjet e tyre, shoqatat e të drejtave të njeriut, të rinjtë, të cilët mbeten ende larg informimit dhe njohurisë për atë që ka ndodhur, sepse nuk e kanë jetuar këtë periudhë, dhe publikut të gjerë. Kur them publikut të gjerë kam parasysh të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen, pasi e kemi zgjeruar goxha harkun e punës sonë. Ne kemi ndërtuar format e punës për të ulur kostot e transaksionit të qytetarëve atje dhe të marrim në një kohë të shpejtë përgjigje për sa u përket dokumenteve të ish-Sigurimit, të cilat na rezultojnë në një masë të konsiderueshme. Ne kemi një marrëveshje aktive në Kosovë, në Maqedoni, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, qoftë me shoqatën shqiptare “Vatra”, qoftë me “Zërin e Amerikës”.

Edhe në Shqipëri kemi bërë një punë të konsiderueshme për të dalë nga qyteti i Tiranës, ku kemi një projekt, të cilin e kemi ndarë në nën zë dhe quhet “Dialogu lokal për komunizmin”, kemi shkuar në Shkodër, Tepelenë, Konispol, Pukë, Mirditë, Berat, Korçë dhe Gjirokastrë. Kjo do të thotë se po e prekim Shqipërinë gjerësisht. Kemi ndërtuar dialogje të drejtpërdrejta me shoqatat e ish të përndjekurve, me qytetarë, me familje, me media dhe pushtet vendor, të cilat kanë rezultuar shumë të frytshme.

Për sa i përket marrjes së eksperiencës, kemi vazhduar punën tonë për të marrë eksperiencë dhe për të ngritur komunitetet e shqiptarëve kudo në Europë, mjafton të përmend Gjermaninë, ku vazhdojmë të marrim asistencë teknike, Poloninë, Bullgarinë, Rumaninë dhe Izraelin, të cilat kanë arritje në fushën e kujtesës.

Ne jemi koshientë që arkivi që zotëron institucioni ynë ka jo vetëm vlerë historike, por edhe vlerë të natyrës operative dhe për këtë arsye kemi bashkëpunuar shumë me institucionet publike dhe homologe, qofshin ato studimore akademike, media, qofshin ato me natyrë të sigurisë kombëtare. Ne e kemi konsoliduar këtë bashkëpunim dhe kemi shtuar përmasën gjeografike, që e përmenda më lart.

Lidhur me bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare, Kombet e Bashkuara mbeten partnerë tanë ndërkombëtarë. Siç jeni në dijeni, Autoriteti ka një rol të rëndësishëm për sa i përket zbatimit të qëllimit **mijëvjeçarit** numër 17, i cili lidhet drejtpërsëdrejti me besimin e qytetarëve në institucionet demokratike dhe, njëkohësisht, lidhet drejtpërdrejt me zbatimin e Konventës së OKB-së Ndërkombëtare për Mbrojtjen e Personave nga Zhdukja me Forcë. Në raportimin që qeveria shqiptare bëri në Gjenevë, Autoriteti mori pjesë në komisionin ndërkombëtar për raportimin e kësaj konvente.

Për sa i përket qartësimin të fatit të të zhdukurve me forcë, vëmë re që familjarët vijnë dhe kërkojnë të zhdukurit. Deri tani kemi rreth 47 raste individuale që kanë ardhur dhe kanë aplikuar. Për të përmirësuar punën e Autoritetit, ne kemi bërë një bashkëpunim shumë të mirë me Komisionin Ndërkombëtar të Gjetjeve të të Zhdukurve, ku në bashkëpunim me ta kemi dy aplikacione online, njëri aplikacion ka të bëjë me raportimin e personave të zhdukur, nga qytetarë brenda dhe jashtë vendit, ndërsa aplikacioni tjetër ka të bëjë me vendvarrimet e fshehta ose vendkeqekutimet e fshehta. Dje vura re se janë raportuar në aplikacion rreth 17 vendvarrime. Qëllimi ynë, të cilin e keni miratuar përmes ligjit të trashëgimisë kulturore, është që këto vendvarrime dhe vendkeqekutime jo vetëm të trajtohen në mënyrën e duhur nga organizatat e specializuara ligjzbatuese, por njëkohësisht të trajtohen edhe si vende të ndërgjegjësimit dhe vetëdijes kombëtare. Në këtë frymë kemi bërë edhe një bashkëpunim të frytshëm me Bashkinë e Tiranës, ku vendvarrimi i 22 martirëve, të cilët u ekzekutuan pa gjyq, me rastin e të ashtuquajturës “Incidente të bombës sovjetike” përfshirë edhe të nderuarën Sabiha Kasimatin, po punohet që të kthehet në vend ndërgjegjësimi, ndërkohë që rrugës, e cila të çon te ky vendvarrim i fshehtë, në përkujtim të kësaj ngjarjeje i është vënë emri “26 shkurti”.

Njëkohësisht kemi bërë avancime të dukshme dhe ndihemi mirë që vjet në muajin nëntor u mbajt konferenca e parë shkencore e titulluar “Të mohuar nga regjimi, burgjet, sistemi i internim-dëbimeve dhe puna e detyruar në Shqipërinë e viteve 1945-1990”, e cila ishte një

konferencë ndërkombëtare, ku aplikuan rreth 38 studiues brenda dhe jashtë vendit. Aty pati punime shumë të mira dhe ishte një arritje, sepse u bë një bashkëpunim mes 4 institucioneve që janë specializuar në këtë fushë, përfshirë edhe Institutin e Historisë. Ajo ishte një konferencë 2-ditore, punimet e së cilës ne po i redaktojmë dhe do t'i botojmë shumë shpejt.

Një arritje tjetër lidhur me publikimet ishte bashkëpunimi me qeverinë zvicerane për të hapur dosjet e akademikëve apo shkencëtarëve të 10-vjeçarit të parë '44-55 për të treguar historinë e varrosur të Institutit të Shkencës. Ne e kemi sjellë punimin këtu, i cili titullohet "Kur sigurimi merrej me shkencë", ku janë hapur dosjet e 9 studiuesve për të parë që edhe ata persona, të cilët ishin të nderuar publikisht dhe të vlerësuar nga regjimi, kishin dosjet e tyre të përndjekjes, që u kufizohej edhe një herë e drejta. Ata e përjetuan shkallën e përndjekjes njëlloj si shkencëtarja Sabiha Kasimati, e cila u ekzekutua pa gjyq, ose në forma të ndryshme të kufizimit të lirisë së tyre, qoftë edhe akademike.

Një arritje tjetër ka qenë edhe themelimi i platformës së dëshmimeve gojore, që ne e kemi titulluar "Edhe muret kanë veshë". Kemi sjellë disa fletëpalosje, të cilat dua t'ua shpërndaj deputetëve. Qeveria gjermane na ka mbështetur me teknologjinë, që ka të bëjë me servera dhe mjete regjistrimi. Kjo konsiston në atë që viktimat e komunizmit janë ende gjallë dhe historitë merren përmes metodave të shkencore nga njerëz të specializuar. Këto dëshmi jo vetëm do të mblidhen, por do të ruhen në kushte optimale në dy kopje dhe do t'u vihen në dispozicion studiuesve në të ardhmen dhe në çdo kohë.

Publikimi i parë ka të bëjë me dëshmitë e mbledhura nga të mbijetuarit e kampit të Tepelenës, që kemi këtu dhe është një publikim që është vlerësuar shumë. Njëkohësisht të gjitha këto vendosen në dy gjuhë: në shqip dhe në anglisht, në faqet *online* që titullohet "Edhe muret kanë veshë".

Për sa u përket profileve biografike, që filluan me figurat akademike, është themeluar një platformë *online*, që titullohet dosjet.gov.al. Aty ne vazhdimisht do t'i pasurojmë profilet biografike të personave, gjithmonë nën këndvështrimin e mënyrës dhe trajtimit që Sigurimi u bëri atyre. Kjo platformë do të ketë qasje të plotë biografike, pra do të fusim edhe materiale arkivore, por, njëkohësisht, edhe elemente nga arkivat e familjeve dhe nga dëshmitë e personave.

Një libër, që e presim së shpejti, por që është bërë një dosje e hapur e të dënuarve të "Kënetës së Maliqit". Kjo është një punë e studiuesve, dosja e hapur është komplet e tyre dhe do të jetë një ilustrim i mirë se si ka funksionuar drejtësia e asaj kohe, gjithmonë me një shqyrtim juridiko-historik. Pra, edhe ky libër del tani, sepse është bërë gati.

Me pak fjalë, dua t'ju them disa sfida që kemi, të cilat janë shumë serioze dhe do të doja shumë vëmendjen e këtij komisioni. Ju jeni në dijeni që ende sot e kësaj dite Autoriteti funksionon me vetëm 50 % të strukturës së tij. Ne nuk na është plotësuar ende gjysma e strukturës. Një koleg bën punën e dy personave, ndërkohë që puna është shtuar, është sofistikuar, pritshmëritë e publikut janë të mëdha, çështjet e komunizmit dhe të sigurimit janë në rendin e ditës. Ne gjendemi në pamundësinë për t'i plotësuar këto politika që i kemi vënë vetes, lëre më të marrin politika të reja. Ajo që ndihet drejtpërsëdrejti si sfidë është radha e gjatë e qytetarëve, që ndonjëherë shkon edhe 1 vit e gjysmë. Ne na vjen keq, sepse qytetarët e prekur kanë një moshë të tillë, që nuk mund të presin shumë. Pra, kërkojmë mbështetjen tuaj maksimale, që të paktën me buxhetin suplementar, që do të kalojë në qershor, të na plotësohet struktura. Është një detyrim që e ka parlamenti, e ka qeveria, pra është një ligj, të cilin e keni miratuar vetë, ta bëjmë funksional më së miri. Nuk mund të punojmë në kushte emergjence.

Së dyti, për sa i përket krijimi të kushteve optimale për ushtrimin e veprimtarisë sonë, këtu nuk bëhet fjalë për luks, këtu bëhet fjalë për plotësimin e kushteve për një arkiv të karakterit historik, për të zbatuar standardet që vetë shteti ynë i ka, për kushte teknike për mirëmbajtjen nga lagështira, nga mbrojtja, nga zjarri, nga temperaturat e larta apo të ulëta. Pra, janë materiale të një vlere të pazëvendësueshme, janë sekrete dhe kërkojnë kushte. Në kushtet që ato janë, kanë risqe të konsiderueshme. Ne i kemi bërë analizat e këtyre risqeve, kemi bërë të gjitha projektet. Një godinë shumë e përshtatshme na është vënë në dispozicion, por edhe këtë vit përsëri fondi që na u dha në dispozicion për investime është vetëm 20 mijë dollarë, që nuk i plotëson as kushtet minimale për kompjuterë dhe PBA-ja që na u prezantua vazhdon të mbetet me 20 mijë dollarë investime. Pra, në një anë na jepet një godinë shumë e përshtatshme, në anën tjetër, nuk na jepet mundësi që ta përshtatim këtë godinë dhe të punojmë.

Së treti, edhe këtu pres mbështetjen tuaj, sepse kemi ende një vit që punojmë pa një anëtar autoriteti dhe e ndiejmë mungesën. Anëtarët e autoritetit kanë një funksion të rëndësishëm. Ne mbledhemi dy herë në javë dhe mbledhjet janë të gjata. Materialet që shqyrtohen u vijnë dy ditë përpara dhe ata duhet t'i lexojnë. Vërtet ne nuk kemi një ndarje pune, por e ndiejmë nevojën që ky person të vijë.

Transporti i mjeteve arkivore bëhet me prezencën e dy anëtarëve të Autoritetit, që duhet të shkojnë t'i shoqërojnë fizikisht. Vetë hulumtimi në arkivat e rrjetit duhet të bëhet me anëtarët e autoritetit, që kanë të drejtë absolute në çdo arkiv të rrjetit që të shkojnë dhe të hulumtojnë. Ne kemi informacione që fondet që na perkasin neve, ndodhen në rrjetin arkivor, mirëpo një person mungon na i "pret krahët" dhe na jep më pak eficiencë.

Së fundi, është një problem i rëndësishëm, që vërtet dua të merret seriozisht edhe si prioritet. Tashmë për ne është bërë e qartë që trajtimi i së shkuarës, përballja me të shkuarën, është një gjë shumë e rëndësishme. Ndonëse Shqipëria ka shumë halle, kjo është shumë e rëndësishme. Çdo gazetë në faqe të parë e prek komunizmin, në të gjitha faqet e kulturës, të historisë të trajtohet. Unë e kam parë vetë. Çdo aktivitet yni ka dalë rregullisht, ka tërhequr vëmendjen e medieve dhe të publikut. Aktivitet tona janë me një rritje të madhe. Në çdo qytet që kemi shkuar, janë mbushur sallat nga njerëz, që nuk kanë pasur lidhje pra ka interes. Ne mendojmë se ky interes i lartë i publikut, duhet të përkthehet edhe në një angazhim shumë të madh, jo vetëm të institucionit tonë, por të të gjitha institucioneve.

Ajo që ne vemë re është se nuk do të mjaftojë një ligj për të drejtën për informim, që komunistizimi ose përballja me të shkuarën të trajtohen, ashtu siç duhet. Për këtë arsye në mënyrë si kolegjiale, kështu siç jemi 4 anëtarë, kemi marrë vendimin për të parë se ku mund të ndërhyhet në legjislacione të ndryshme për të mundësuar dhe për të harmonizuar zbatimin e ligjit tonë me ligje të ndryshme të sektorëve të ndryshëm.

Zoti kryetar dhe zotërinj anëtarë, kam me vete dhe dua t’jua jap publikisht disa ndryshime që lidhen me ligjin nr. 45/2015.

Së dyti, kam sjell me vete disa propozime që ne si autoritet bëjmë për të ndryshuar rregulloren e sigurimit të personelit, pra proceset e pajisjes me certifikatë sigurie, që të gjitha këto të na lejojnë të bëjmë punën tonë, të na japim kohë që të harmonizojmë procesin e verifikimit me procesin verifikimit të certifikatave të sigurisë.

Së treti, është një propozim që ia kemi çuar komisionit bipartizan për reformën zgjedhore, ia kemi çuar KQZ-së dhe po jua sjell edhe juve publikisht. Ne kemi bindjen se, duke bërë disa ndryshime në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, mundet fare mirë si institucion të vihem në punë dhe të bëhemi sa më të vlefshëm që verifikimi i kandidatëve për zgjedhje lokale apo vendore të kalojë edhe nga institucioni ynë.

Së katërti, janë disa ndryshime për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë. Përsëri bëhet fjalë për harmonizimin e ligjeve, që edhe ligji ynë të funksionojë mirë akoma. Teknikisht e kemi çuar në Ministrinë e Jashtme. Këtu kemi disa propozime dhe do të donim shumë përkrahjen tuaj që të shikohej si paketë dhe të na lejonit neve mundësinë që të funksionojë më mirë.

Tashmë jemi të gjithë koeshientë dhe si institucion ndihemi palë e debatit publik për sa u përket reformave të mundshme në ligjin e partive politike ose në ligjin e pushtetit vendor dhe u kërkojmë mirëkuptim të na thërrisni dhe të na bëni pjese të tryezave. Tashmë kemi goxha eksperiencë dhe dimë se si mund të bëjmë më të zbatueshëm ligjin tonë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Sula!

Fjalën e ka zoti Shameti për të bërë një përmbledhje të gjetjeve të raportit voluminoz që ka sjellë autoriteti për vitin 2018, më pas do të kalojmë në pyetje dhe diskutime nga kolegët.

Adnor Shameti - Faleminderit, zoti kryetar!

Dua të falënderoj të gjithë përfaqësuesit e autoritetit për punën voluminoze dhe të lavdërueshme që kanë bërë për vitin 2018!

Së pari, dua t'i referohem rezolutës së vitit të kaluar dhe përmbushjes së atyre gjetjeve. Referuar informacionit të paraqitur në raportin vjetor dhe informacioneve të mëparshme të paraqitura nga autoriteti me kërkesën e Kuvendit, rezulton se janë përmbushur pothuajse të gjitha rekomandimet e lëna në rezolutën e një viti më parë, me përjashtim të rekomandimit të përfundimit të procesit të marrjes në dorëzim dhe inventarizimit të të gjitha dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, që gjenden në institucione të tjera të rrjetit arkivor, si arkivi shtetëror i sistemit gjyqësor, ai Forcave të Armatosura e të tjera.

Përfundimi i këtij procesi është i nevojshëm të mbyllet brenda vitit 2019, sepse, në të kundërt, cenohet realizimi i një nga objektivat primare të ligjit, që është edhe informimi i institucioneve përkatëse, lidhur me ekzistencën e informacioneve në dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, kur kjo kërkohet në kuadër të vlerësimit të kandidatëve për t'u emëruar apo ngritur në detyrë.

Vlerësimi i performancës së institucionit nga këndvështrimi i Shërbimit të Monitorimit të Kuvendit, duke qenë se ky është raporti i dytë që autoriteti ka paraqitur në Kuvend, mbështetet në të dhënat e prezantuara në raport dhe bëhet krahasimi i tyre me të dhënat e një viti më parë, duke përfshirë këtu edhe përmbushjen e detyrave funksionale që ligji nr. 45/2015, si dhe rezoluta e datës 28.06. 2018 “Për vlerësimin e veprimtarisë së autoritetit” i ngarkuan këtij institucioni. Nuk po ndalem më shumë te vlerësimi i punës së autoritetit, që drejtuesja e autoritetit e paraqiti në mënyrë shteruese para komisionit, por dua të përqendrohem më tepër te problematikat e dala nga monitorimi vjetor dhe periodik, si dhe rekomandimet për punën për vitin e ardhshëm.

Problematikat që ka nxjerrë Shërbimi i Monitorimit vjetor dhe periodik. Vendimmarrja kolegjiale e institucionit është vështirësuar nga mospërfundimi i procedurave të nisura nga Kuvendi për zëvendësimin e një prej anëtarëve të autoritetit, i cili ka më se një vit që ka dhënë dorëheqjen, sikurse edhe përfaqësuesja e autoritetit e ngriti para komisionit.

Procesi i marrjes në dorëzim dhe inventarizimi i materialit arkivor të ish- Sigurimit të Shtetit nuk ka përfunduar ende, sepse kapacitet e burimeve njerëzore për të përballuar

volumin e madh të dokumenteve janë të përgjysmuara, si dhe godina e vendosur në dispozicion të autoritetit nuk siguron kushtet optimale për ruajtjen e dokumenteve arkivore, sikurse doli edhe në relatin e përfaqësuesve të autoritetit.

Funksionimi gjatë vitit 2018 me kapacitete të burimeve njerëzore të përgjysmuara jo vetëm ka sjellë vështirësi për trajtimin dhe verifikimin brenda afateve të kërkesave të paraqitura nga institucioni, individët dhe studiuesit, por ka ndikuar në paraqitjen e rezultateve të gabuara të verifikimit, të cilat më pas kanë përfunduar në një vendimarrje të korigjuar të Autoritetit, duke rrezikuar stabilitetin e procesit në tërësi. Mungesa e fondeve për rikonstruktimin e një pjese të godinës së autoritetit rrezikon dëmtimin e mëtejshëm të materialit arkivor dhe pengon realizimin e projekteve financuese për pjesën tjetër të godinës të siguar nga donatorët e huaj.

Autoriteti nuk u është përgjigjur në kohë kërkesave të ISKK-së për disa dosje gjatë vitit 2018, duke shtyrë afatin e zbatimit të disa projekteve kërkimore të ISKK-së

Rekomandimet e Shërbimit të Monitorimit për Autoritetin dhe institucionin për vitin në vijim

Të përfundojë brenda vitit 2019 procesi i marrjes në dorëzim dhe inventarizimi i të gjitha dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit, që gjenden në institucione të tjera të rrjetit arkivor.

Të përgatitet infrastruktura logjistike e nevojshme për përfundimin brenda vitit 2019 të procesit të transferimit nga arkivat e institucioneve të ndryshme të të gjithë dokumentacionit, që është marrë në dorëzim nga autoriteti, si dhe për angazhimin maksimal të të gjitha palëve të përfshira në proces për ndërmarrjen e hapave për parandalimin e dëmtimit të mëtejshëm dhe për të siguruar ruajtjen e materialit arkivor ekzistues.

Të rritet bashkëpunimi me institucionet qeveritare për përfundimin sa më parë të procesit të identifikimit dhe rikuperimit të trupave të atyre, që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit, si dhe për marrjen e masave të menjëhershme për të ruajtur dhe mbrojtur në mënyrë adekuate vendet, që janë aktualisht të identifikuara si varreza masive.

Të bëhet publikimi i vendimeve dhe materialeve të miratuara nga autoriteti në funksion të transparencës dhe informimit, duke respektuar kufizimet e legjislacionit së fushës për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale.

Të përfundojë sa më parë implementimi dhe zhvillimi i sistemeve të menaxhimit të çështjeve dhe të arkivit dixhital, që do të shërbejë në drejtim të mirëorganizimit dhe lehtësimit të të gjithë procesit të punës në institucion. Të konsolidohet bashkëpunimi me ISKK-në, me fokus të veçantë çështjet që kanë të bëjnë me aksesimin e arkivave nga të dyja institucionet.

Të vazhdojë informimin me qëllim rritjen e ndjeshmërisë publike ndaj krimeve të komunizmit përmes aktiviteteve, botimeve, medias dhe rrjeteve sociale.

Faleminderit!

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Shameti!

A ka pyetje nga kolegët?

Urdhëroni, zoti Fino!

Bashkim Fino - Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderoj autoritetin që është prezent!

Natyrisht, ky informacion vjetor nga pikëpamja e formës dhe e përmbajtjes është shumë i bollshëm dhe shumë i nevojshëm për ne. Nga 482 vendime që keni marrë, 466 prej tyre janë miratuar në mënyrë unanime, dhe 16 vendime nuk janë miratuar në mënyrë unanime, por në faqen tuaj zyrtare të institucionit nuk ka asnjë të dhënë informative, pse këto 16 vendime nuk kanë pasur vendim unanimit?

Së dyti, nuk mendoj, pavarësisht se e tha relatori, se mungesa e një anëtari mund të bëjë të pamundur verifikimin dhe marrjen e vendimeve, pavarësisht vonesave nga ky komision.

Besoj se gjatë muajve të ardhshëm do ta trajtojmë edhe një vend vakant, që është në autoritet, dhe do ta kalojmë shumë shpejt. Nga informacioni që kam këtu rezulton se dy nga kandidatët e verifikuar nga autoriteti tuaj, kanë nxjerrë vendime të pasakta, të cilat më pas janë korrigjuar. Ka pasur edhe një debat në medie për këtë çështje. Natyrisht, ky është një veprim, për të cilin është e drejta juaj të jepni informacionin dhe përgjigjen përfundimtare, por kur dikush bën një kërkesë, i jepet një përgjigje pozitive apo negative, krijohet një lëmsh në publik, pastaj ky autoritet tërhiqet dhe thotë se për figurën, për shembull po marr emrin tim, nuk është ajo që kemi thënë më parë, por është ndryshuar vendimi, kjo krijon një kakofoni dhe një problem jo vetëm për atë si person, por edhe për publikun e gjerë. Mendoj se duhet të jeni shumë të kujdesshëm në sensin kur vendimmarrja është e argumentuar saktë nga ju, por duhet të jetë e qartë edhe për publikun dhe individin. Në rastin konkret, ajo që ka ndodhur me dy kandidaturat, më duhet të them se nuk është korrekte. E keni në relacion.

Për sa i përket pjesës së buxhetit, që ka të bëjë me pagat, me ushtrimin e detyrës, mendoj se e kemi lënë të hapur. Bëtë mirë që ju i thatë në analizë, por do të ishte mirë, kryetar, që ne t'i monitorojmë të gjitha institucionet që kemi në varësinë tonë. Edhe në këtë institucion do të ishte mirë të kishim një monitorim më të mirë për të parë se si është situata, për të krijuar bindje edhe për anëtarët e komisionit kur të vijë buxheti shtesë apo buxheti në tërësi, në mënyrë që të zgjidhet dhe të realizohet, sidomos pjesa që ka të bëjnë me mirëmbajtjen e dokumentacionit, që është shumë e rëndësishme, pa lënë pas dore edhe numrin e punonjësve,

që është duke u përmirësuar dhe do të vijë duke u rritur dhe duke u kompletuar, sipas dijenisë sime, sepse kam qenë relator për buxhetin, pra do ta zgjidhim shumë shpejt.

Këto ishin sugjerimet e mia për raportin.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Zonja Hysi ka një pyetje.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj të gjithë përfaqësuesit e Autoritetit të Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit. Në fakt, kam pasur mundësi ta ndjek veprimtarinë tuaj dhe jeni për t'u përgëzuar për rritjen e aktivitetit jo vetëm në Tiranë, por në të gjithë territorin e vendit. Njëkohësisht, mendoj se një nga elementet shumë të rëndësishme, që duhet të citohet edhe në projektrezolutë, është aktiviteti shumë i zgjeruar dhe informues, sensibilizues lidhur me veprimtarinë tuaj, por edhe për të rikujtuar, për të sjellë në kujtesën e njerëzve ato që kanë ndodhur, me qëllim që të mos përsëriten.

Po lexoja me vëmendje raportin dhe një material të përgatitur nga Shërbimi i Monitorimit i Kuvendit dhe me rezultoi se për vitin 2018 ju keni trajtuar dhe keni në proces trajtimi 612 kërkesa individuale. Nga ana tjetër, pajtohem me shqetësimin tuaj për mungesën e burimeve njerëzore dhe të një anëtarit të bordit të autoritetit, gjë të cilën Komisioni i Ligjeve do ta zgjidhë shumë shpejt. Pyetja ime ka të bëjë me kohëzgjatjen e trajtimit të një kërkesë. Sa kohë merr mesatarisht një kërkesë?

E dyta, në raport thuhet se në fillim ka qenë pak e vështirë për të pasur një vendimarrje, sepse ju merrni informacione nga institucionet e tjera, në vitin 2019 a është kapërcyer kjo vështirësi? A jeni në gjendje të jepni një përgjigje të saktë për verifikimin e figurës së një personi me dokumentet dhe me burimet njerëzore që keni? Gjithashtu, nga informacioni që keni dhënë në raport, rezulton se nga 1284 kërkesa institucionale për verifikime, 30 persona kanë rezultuar se kanë dokumente në dosjet e ish-Sigurimit të Shtetit. Më vjen mirë që e keni dhënë në raport këtë shifër, sepse në medie këto kohët e fundit kemi dëgjuar shifra nga më të çuditshmet. Kjo tregon edhe një herë se sa i rëndësishëm është ajo faqja e internetit, që e përmendi me të drejtë kolegu Fino. Pra, ju te këta 30 persona që i keni gjetur me dokumentacion në ish-Sigurimin e Shtetit, përfshini edhe rastet, të cilat janë në proces gjyqësor, pra kur personat kanë reaguar dhe nuk e kanë pranuar?

Zoti kryetar, nëse më lejon, që të mos e marr sërish fjalën, do të ishte e rekomandueshme që në projektrezolutën, që do të përgatisim, t'i jepet rëndësi transparencës dhe informacionit për procesin vendimarrës të autoritetit, duke ruajtur të dhënat personale.

Do të ishte mirë që në faqen tuaj të kishit informacion, sikurse e keni për të gjitha aktivitetet e tjera që bëni, me qëllim që të shmanget edhe kakofonia që ekziston, edhe stërhollimi, ose shifrat që jepen në medie, të cilat nuk janë reale. Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Fjalën e ka zonja Suli për t’u dhënë përgjigje pyetjeve të koleges.

Gentiana Sula – Ju falënderoj për vlerësimet, për fjalët e mira dhe për pyetjet, sepse na japin mundësi të sqarojmë disa gjëra! E vlerësoj rekomandimin e të dy anëtarëve të nderuar të komisionit për sa i përket publikimit të vendimeve. Në raport me këtë, dua të them se ne tashmë kemi përpunuar një rregullore për publikimin e vendimeve tona, të cilat kanë të dhëna personale nga më të ndryshmet. E kemi bërë në bashkëpunim me Komisionerin për të Dhënat Personale, e kemi miratuar në autoritet dhe kemi përgatitur drafte buletinesh dymujore. I kemi gati, por i kemi në shtyp, dhe me vjen keq që nuk munda t’i sillja sot. Pra, çdo dy muaj do të ketë përmbledhje botimesh. Ka nja problem që lidhet me faktin nëse mund t’i publikojmë vendimet tona për ata persona që mund të jenë në ankimim ose gjykim. Ky ka qenë edhe ngërçi ynë, sepse natyra e dokumenteve është e tillë. Ne kemi thënë që shpeshherë është përbaltëse. Nuk janë të verifikueshme lehtësisht, sepse nuk është e lehtë ta nxjerrësh një informacion. Shpeshherë duhet të dëgjohet edhe zëri i personit të prekur. Domethënë, bëhen shumë analiza dhe konsiderata më parë. Prandaj kemi vendosur buletinin 2-mujor. Është ezauruar edhe koha e ankimit të personit kur dalin. Megjithëse është me iniciale, duke qenë se është një detyrë e lartë publike, është e kuptueshme se kush është personi dhe ne e kemi vënë re këtë. Kështu që me këtë qasje jemi. Gjithsesi, ne do t’jua çojmë juve. Mendoj se komisioni dhe instrumenti i monitorimit tuaj duhet ta shohë këtë rregullore. Nëse ju duket e përshtatshme, i kemi të gjitha publikimet gati. Kemi vendosur të mos i nxjerrim të gjata, por të jenë të përmbledhura, me iniciale. Ndërkohë, i nxjerrim të gjitha deklasifikimet, pra në Fletoren Zyrtare dhe në faqen e internetit.

Nëse na e pengon punën mungesa e anëtarit, unë them se na pengon, sepse ai është përfaqësuesi i grupit të të përndjekurve politikë. Megjithëse zoti Simon nga Shoqata e të Drejtave të Njeriut i përfaqëson, do të ishte mirë t’i kishim aty. Nuk është vetëm një vendimmarrje, por është një funksion i këtij personi, i cili duhet të shkojë në rrjetin arkivor, duhet të bëjë shoqërimin fizik, ekzaminimin e fondeve të ndryshme. Pra, është një person që na mungon dhe unë e mirëkuptoj që jeni në proces.

Do të doja që zoti Marin të përgjigjet për bashkëpunimin tonë me Institutin e Studimit të Krimeve. U tha që këtu që ne kemi vonuar...

Ulsi Manja – Ata kanë hall studimin.

Zoti Marenglen, ju lutem, një përgjigje.

Marenglen Kasmi – Ne kemi pasur një bashkëpunim shumë intensiv gjatë këtyre dy vjetve e gjysmë që funksionojmë me Institutin e Studimit të Krimeve të Komunizmit. Kemi nënshkruar një bashkëpunim me ta. Gjithashtu, kanë qenë pjesë e të gjitha aktiviteteve që kemi kryer.

Për sa i përket vonesës së përdorimit të dokumentacionit arkivor, në fakt, e para shërbejnë së më shpejt të jetë e mundur, e dyta, ligji na detyron shumë qartë për mënyrën se si përdoren dhe vihen në dispozicion këto dokumente. Nëse përdorimi në mënyrë strikte i këtij dokumentacioni, sipas ligjit, konsiderohet si mungesë bashkëpunimi apo si vonesë, kjo është diçka së cilës ne nuk mund t'i përgjigjemi. Fakt është koha pak e gjatë. Kryetarja jua tha problemet që kemi, mangësitë në staf etj. Nga ana tjetër, nuk ka pasur asnjë vonesë, e cila të ketë pasur qëllim apo të trajtohet ndryshe nga të tjerat. Numri i kërkesave studimore është shumë i lartë. Mundohemi, sidomos për institucionet, të jemi në dispozicion në një kohë sa më të shpejtë.

Ulsi Manja – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Hoxha.

Altin Hoxha – Faleminderit, zoti kryetar!

Lidhur me pyetjen që bëri zoti Fino për sa u përket 16 vendimeve që nuk kanë qenë unanime, besoj se doli edhe nga përgjigjet e mëparshme që ne kemi marrë vendim për publikimin e tyre, pra do të publikohen edhe vendimet e mëparshme, por ato vendime dhe pjesa kundër e një vendimi i janë bërë të ditur subjektivit.

Lidhur me korrigjimet e vendimeve për dy persona, është e vërtetë që kemi pasur dy raste gjatë vitit të kaluar që ne jemi vetëkorrigjuar. Njëri nga rastet ka të bëjë me mungesën e stafit dhe me një mosgjetje në kohën e duhur të dokumenteve arkivore. Menjëherë, pas një kërkimi të thelluar, e kemi korrigjuar vendimin që kemi marrë. Rasti i dytë lidhet me probleme arkivore të ndërlikuara. Ka raste kur ka përputhje gjeneralitetesh, ka raste kur ka përputhje të plota të gjeneraliteteve, emër, mbiemër, emri i babës, ditëlindje. Për shkak të mungesës së stafit përsëri nuk është bërë dallimi i duhur. Përgjigjja për një rast identik dhe të kësaj natyre ka qenë e tillë. Menjëherë pas ankimit të subjektivit, në mbledhjen më të parë e kemi korrigjuar vendimin që kemi marrë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sigurisht, sepse është vetëm një punonjës...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është çështje e kërkimit të thelluar.

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zoti Vrioni, një përgjigje të shkurtër që të vazhdojmë me seancën.

Skënder Vrioni – Faleminderit, zoti Fino për pyetjen!

Realisht, nuk është thjesht mungesa e stafit. Ka dispozita të caktuara në ligjin nr. 45/2015...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në plotësim të përgjigjes....

Ulsi Manja – Zoti Vrioni, ju lutem, bëni një plotësim të përgjigjeve.

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti Vrioni, afrojeni mikrofonin!

Skënder Vrioni – Po bëj një plotësim të pyetjes në kuadrin ligjor. Ka dispozita të caktuara në ligjin nr. 45/2015, konkretisht pika 6 e nenit 5, e cila e detyron autoritetin dhe i jep të gjitha kompetencat për të shqyrtuar kërkesat ankimore, pra autoriteti kryesisht vihet vetë në lëvizje, por edhe me kërkesa ankimore për të bërë korrigjimet në pasaktësitë e konstatuara nga ai vetë. Në dy rastet konkrete thjesht kemi bërë klasifikimin e veprimtarisë ligjore të autoritetit, duke e klasifikuar nga një pikë e një dispozite në një tjetër, siç është neni 29, pika 2, nga pika B në pikën C, por nuk kemi shfuqizuar në tërësi aktin, sepse në gjitha vendimet e autoritetit kemi thënë “nga verifikimet e deritanishme”. Kjo do të thotë se në çdo situatë, në çdo moment për të gjitha argumentet që dha edhe titullarja e institucionit, ne e verifikojmë dhe na vijnë dokumente shtese. Kur vijnë dokumente shtese, autoriteti vihet menjëherë në lëvizje dhe në kontekstin e nenit 5, pika 6, por edhe të neneve 37, 38 dhe 39, që legjislatori i ka dhënë kompetencë autoritetit, kryesisht korrigjon pasaktësitë e konstatuara, por jo aktin në tërësi. Kjo ishte ana ligjore.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Vrioni!

Ka një pyetje të fundit zoti Braho.

Spartak Braho – Në veprimtarinë e tij autoriteti studion materiale me burime arkivore nga i gjithë sistemi arkivor i Republikës së Shqipërisë, a jeni të pajisur ju me certifikata sigurie?

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Braho!

Po, zoti Hoxha.

Altin Hoxha – Të gjithë anëtarët e autoritetit janë të pajisur, por edhe stafi i sekretariatit teknik është i pajisur me certifikatë sigurie.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hoxha!

Po, zonja Sula.

Gentiana Sula- Kjo është një pyetje me interes që bëri zonja Hysi, e cila ka të bëjë me kohëzgjatjen e një përgjigjeje. Meqenëse është mundësia më lejoni ta sqaroj: kohëzgjatja varet nga ajo që gjendet. Për shembull, kishim një rast dje, një ish-ambasador që është përndjekur, përveç se u hap dosja hetimore gjyqësore, kjo është e thjeshtë, pastaj u hap dosja e përndjekjes, e përpunimit, e cila kaloi në proces deklasifikimi, anonimizimi, dixhitalizimi, aty konkluduan familjarët se kishin 59 bashkëpunëtorë dhe ata duan që të zbardhet. Kjo është një fazë tjetër për ne që të identifikojmë çdo bashkëpunëtor, të trajtojmë çdo material të tij, pra varet, është shumë e ndryshme. Është një punë shumë voluminoze. Ndihe mi, sepse familjarët vijnë gjithmonë dhe na falënderojnë dhe besoj se ky shërbim që po bëhet është një gjë shumë e mirë.

Ulsi Manja - Faleminderit, zonja Sula!

Ka diskutime? Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Ajo që më bën më shumë përshtypje në këtë seancë dhe që duhet ta kuptojë publiku është se ne e kemi krijuar këtë institucion shumë të rëndësishëm dhe kemi bërë shumë mirë, por ky institucion përveçse duhet të na japë informacione dhe dokumente të rëndësishme, përveçse duhet të bashkëpunojë me autoritetet vendase dhe me institucionet e tjera ndërkombëtare, që është gjë shumë e mirë, unë i mëshoj fort idesë dhe sugjerimit tim se verifikimet që bën autoriteti duhet të jenë të sakta dhe precize. Nuk mund të justifikohesh sot këtu për mungesë të fondeve, të kapaciteteve apo të personelit, kur unë të bëj një kërkesë dhe kërkoj një përgjigje. Autoriteti juaj është i detyruar të japë informacion të saktë, munda ta vonojë në funksion të përgjigjes së fundit që dhatë ju dhe të pyetjes që bëri zonja Hysi, ndoshta disa ditë edhe më shumë, por kur del nga institucioni juaj ai informacion duhet të jetë totalisht i saktë. Çdo informacion tjetër që del dhe pastaj vetëkorrigjohet siç e thatë edhe ju këtu, më pas po nga autoriteti juaj, është në disfavor qoftë të subjektit, por edhe tuajin, në fund të fundit, sepse ka të bëjë me punën e pathelluar dhe të pasaktë që ju mund të bëni, duke krijuar drama të padrejta për individë të caktuar, për njerëz, të cilët e kërkojnë një dokument të caktuar, që mund t'u krijohen probleme në një moment të caktuar. Pavarësisht se nesër thoni: “Më fal!”, e tërhiqni atë çfarë është bërë, por verifikimi i këtij autoriteti për mua është shumë i rëndësishëm. Është i rëndësishëm për publikun, për individin dhe më mirë të zgjatet disa ditë më shumë (për sa kohë dhe ne si Kuvend nuk kemi realizuar dot mundësinë, kam raportin tuaj këtu të hapur të struktura, tek organika e AIDSSH-së) sesa të nxitohe mi të japim përgjigje të gabuar, e cila do të krijojë shumë probleme. Pyetja ime ka të bëjë pikërisht me këtë gjë, ky është edhe thelbi i të gjithë analizës që bëjmë këtu, për të cilën është krijuar dhe autoriteti.

Nuk është çështja për të thënë këtu se po të kishim 3-10 njerëz më tepër përgjigja do të ishte më e saktë në 2 apo 4 raste.

Më vjen mirë, pasi e kam materialin përpara që në disa raste konkrete ju jeni vetëkorrigjuar, në kuptimin që i keni kthyer përgjigje më pas ma saktësi, por problemi qëndron në atë që unë dua të shpreh, që nuk është çështje njerëzish, është çështje vullneti dhe çështje pune cilësore, e punonjësve të cilët janë tek autoriteti juaj. Struktura dhe organika janë pjesë që është kërkuar përherë nga ju me të drejtë. Unë jam një nga mbështetësit që gjithmonë kur ju keni kërkuar më tepër nga buxheti, kam dashur vërtet që ju të keni jo vetëm numrin dhe kapacitetet, por edhe ambientet, të cilat duhet të jenë shumë të përshtatshme, sepse ruajnë dokumente me vlera që i duhen shoqërisë sonë, prandaj duhet edhe një investim. Në pamje të parë ndoshta për hallet dhe problemet që ka Shqipëria duket gjë e vogël dhe thuhet: “Pse t’i japim këto fonde për këtë institucion, kur ka gjëra të tjera më të rëndësishme”, por edhe ky institucion për mendimin tim, duhet të jetë në lartësinë e institucioneve të tjera dhe duhet të ndihmohet patjetër nga buxheti i shtetit, nga Kuvendi i Shqipërisë. Ashtu siç tha edhe kryetari, brenda muajit tjetër do ta kompletojmë autoritetin tuaj edhe me një vend vakant, sepse është çështja jonë që e vendosim, por pse jo edhe për çështjet që kanë të bëjnë me buxhetin për të parë, për të rregulluar gjërat.

Mendoj se puna e mirë që është bërë gjatë vitit të kaluar do një shtysë dhe një ndihmesë edhe nga ana jonë, të paktën në këto 2-3 drejtime që u kërkuan këtu. Pastaj na takon ne të bëjmë monitorim më të thelluar gjatë vitit 2019 edhe në institucionin që është sot prezent. Pastaj të shikojmë edhe në fund të vitit 2018 se çfarë mund të bëjmë për buxhetin e vitit 2019.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Ka diskutime të tjera? Përpara se të mbyllim mbledhjen, kam edhe unë një konsideratë për punën e këtij autoriteti. Ju lutem, një përgjigje të shkurtër, por jo për t’iu përgjigjur kolegut Fino.

Po, zonja Sula.

Gentiana Sula - Për ta sqaruar, viti i parë ishte vitit i identifikimit të fondeve arkivore në rrjetin e Shqipërisë. Viti i dytë ishte marrja në dorëzim, që ishte një proces voluminoz masiv i 2,3 kilometrave materiale. Viti i tretë tashmë është indeksimi, përpunimi i plotë. Mos u çudisni që ne edhe për personat që jemi shprehur, mund të rishprehemi. Për shembull, me zotin Kasmi ishim në arkivin e SHIK-ut dhe pamë materiale shumë të rëndësishme për përfshirjen në shërbimet e huaja që nuk ishin fare të indeksuara. Kjo është një punë e vazhdueshme që do ta bëjmë me përkushtim, por do të ketë edhe korrigjime vendimesh. Për

ne interesi publik prevalon ndaj interesit privat, prandaj dhe publikimin do ta bëjmë pas 2 muajsh që të ezaurohet edhe momenti i ankimit, mund të bëhet ndonjë gabim jo me dashje, por prevalon interesi i publikut. Ne jemi koshientë që marrim pjesë në reforma shumë të rëndësishme dhe bëjmë verifikime të figurave shumë të larta, por ligjin do ta zbatojmë pa u ndalur për sa kohë jemi të sigurt se po bëjmë gjënë më të mirë.

Ulsi Manja - Faleminderit, zonja Sula!

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Zoti Fino, të lutem!

Bashkim Fino- Jam plotësisht dakord me këtë që thatë ju. Unë kam një vërejtje sugjeruese. Na u dhanë 4 dosje këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon).

Mos u shqetëso!

Këto dosje duhet të na vinin me kohë dhe duhet të vinin zyrtarisht te Kryetari i Kuvendi, tek institucioni. Mos të përdorim analizën vjetore që bëjmë për të na thënë: “Kemi 4 dosje që kërkojnë përgjigje nga ju”, si për Kodin Zgjedhor, qoftë çështje të jashtme e të tjera me radhë. Unë mendoj se këto 4 dosje do të ishte më mirë të vinin më përpara si informacion sesa sot.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja- Është një sugjerim me vlerë. Veç raportimit ka edhe propozime konkrete. Ju lutem! Të dëgjojmë nga relatori edhe një konsideratë të fundit.

Adnor Shameti - Zoti kryetar, dua të shpreh konsideratën më të lartë për punën e autoritetit nga njëra anë.

Nga ana tjetër dua të siguroj të gjithë kolegët e nderuar, duke nisur nga zoti Fino, zonja Hysi, se vërejtjet e tyre do t'i pasqyrojmë në rezolutën përfundimtare që do të miratojë Kuvendi dhe përfaqësuesit e autoritetit t'i kenë “vëth në vesh” për veprimtarinë e tyre në vitin në vijim.

Ulsi Manja- Faleminderit!

Nuk besoj se ka më diskutime.

Përpara se të kalojmë në pikën e tretë dhe të fundit të rendit të ditës, do të jap një konsideratë lidhur me punën e autoritetit për vitin 2018. Është një institucion i ri, është në vitin e tretë të punës së tij. Edhe ne kemi përgjegjësitë tona në mbarëvajtjen e punës së këtij institucioni për sa i përket plotësimit të kushteve për të ushtruar si duhet veprimtarinë e këtij institucioni. Këtu e kam fjalën për godinën, për plotësimin e stafit me numrin e nevojshëm të punonjësve. Kuvendi, siç e tha kolegu Fino, çdo vit buxhetor e ka miratuar këtë numër

punonjësish, por kjo nuk është shoqëruar me mbështetjen e duhur buxhetore që edhe institucioni ta ushtrojë si duhet veprimtarinë e tij. Ajo që duhet të merret në konsideratë dhe duhet të evidentohet për punën e mirë të këtij komisionit është fakti se reforma në drejtësi përveç detyrimeve të tjera që ka autoriteti në zbatimin e ligjit nr. 45/ 2015 edhe një numër i madh i ligjeve të reformës në drejtësi i ka dhënë autoritetit një ngarkesë shtesë. Dhe jo më kot po të shikohet raporti, numri i kërkesave institucionale në kuadër të vlerësimit të kandidatëve për t'u emëruar apo ngritur në detyrë nga 48 ka shkuar në 67. Sa për dijeni të publikut ky numër kandidatësh për t'u emëruar ose për t'u ngritur në detyrë ka të bëjë me institucionet e reja të drejtësisë që janë krijuar apo janë në krijim e sipër.

Natyrisht që ka probleme në punën e autoritetit, e thashë edhe më parë se është një institucion i ri, që i kërkohet të hedhë dritë për një periudhë të historisë sonë gati 50 –vjeçare. Ajo që do të kërkoja nga autoriteti sot është se ju duhet të jeni një zë i fuqishëm për të rritur ndjeshmëritë institucionale dhe njerëzore, sa herë që në punën tuaj konstatooni individë që janë në institucione të rëndësishme dhe projektojnë vendimmarrjen apo të ardhmen e fëmijëve tanë. Është shumë e rëndësishme që njerëz në këtë vend që përpunojnë opinionin apo bëjnë moral shoqëror duhet të jenë të pastër dhe pa probleme me të kaluarën. Kjo do të jetë një nga detyrat tuaja përtej rutinës së përditshme: pyetje, përgjigje të institucioneve, Institutit të Krimeve të Komunizmit për qëllime studimore.

Kjo pjesa tjetër është shumë më e rëndësishme, që edhe kryesisht apo kur merrni indicie nga mediet, nga opinioni publik ju duhet të keni një përgjigje në çdo rast. Kjo lidhet edhe me transparencën. Një orë e më parë ju duhet të merrni masat për të fuqizuar faqen zyrtare të institucionit, siç tha kolegu Fino, ato që nuk përbëjnë apo janë deklasifikuar t'i jepen opinionit. Kush janë këta njerëz: institucione, në botën e medias, në shërbimin diplomatik, në drejtësi kudo që të jenë dhe që marrin përsipër të bëjnë moralin e shoqërisë, duhet në radhë të parë të kenë një vijë të kuqe me të kaluarën. Jemi 30 vjet pas rrëzimit të regjimit komunist dhe ende vazhdojmë të përpëlitemi me të kaluarën. Unë jam i bindur se nuk është prekur as maja e ajsbergut e asaj që ka ndodhur për 50 vjet. Duke u nisur edhe nga rastet që me të drejtë kolegu Fino tërhoqi vëmendjen se duhet të jeni të kujdesshëm, më ka bërë përshtypje diçka tjetër, gjatë gjithë kësaj kohe shoqëria nuk reagon, ju jeni një zë i mbytur “një pikë ujë në oqean”. Kur haset, ka individë apo konstatohen njerëz që kanë probleme me të kaluarën, jo vetëm që nuk ndihet zëri juaj, por edhe shoqëria në vetvete, sikur e ka hedhur pas krahëve këtë gjë. Duhet të bëni më tepër për bashkëpunimin me mediet, të forconi bashkëpunimin me këto të fundit, pasi mediet janë zë i fuqishëm në drejtim të transparencës dhe sqarimit të opinionit publik.

Do t'i kërkoj relatorit që bashkëpunimi me mediet duhet të jetë pjesë e rezolutës, atë që nuk e bëjnë dot institucionet apo marrëdhëniet zyrtare e bëjnë më së mirë mediet. Vetëm falë medieeve një pjesë e punës suaj është pasqyruar dhe ka shkuar në vesh të opinionit publik. Ju jeni autoritet që nuk prodhoni dokumentacion, nuk jeni prodhues të këtij të fundit, ju administroni një dokumentacion që e kanë përpunuar të tjerët. Duhet të jeni objektivë edhe për ato dy raste, gabime që kanë ndodhur, nuk kanë pse të ndodhin në të ardhmen edhe pse vetë ligji subjektit të cenuar i ka dhënë të drejtën e ankimit në gjykatë. Njerëz jemi do të bëjmë edhe gabime, por ama ajo që është e shkruar e zeza mbi të bardhë dhe që e ka prodhuar tjetërkush të shkruhet e zeza mbi të bardhë.

Kjo maxhorancë e ka krijuar këtë autoritet, ne e kemi krijuar dhe jemi shumë krenarë, që u kemi dhënë mundësinë shqiptarëve edhe në këtë formë siç është ligji, të njihen me të kaluarën.

Jeni në vitin e tretë të punës, sipas ligjit keni, në mos gaboj edhe 3 vjet të tjera, por nuk besoj se përfundon këtu. Ky institucion nuk duhet të jetë një institucion ku do të punësohen 60 vetë, për nevoja pune do t'i bëjmë edhe 70, por duhet të jetë një zë i fuqishëm në shoqëri. Ju keni një mision tjetër, ndryshe nga shumë aktorë të tjerë që merren me të kaluarën. Instituti e ka për qëllim studimi. Atje studiohet e kaluara, por studiohet mbi bazën e këtyre dokumenteve arkivore, që dispononi ju. Studiuesit le të nxjerrin përgjithësime, konkluzione, analiza, por historia është ajo që është e shkruar aty, e zezë mbi të bardhë.

Kësisoj, unë bashkohem me të gjithë kolegët e mi. Mbështetja e këtij komisioni dhe e Kuvendit për autoritetin që ju drejtoni ka qenë dhe do të jetë, edhe për shkak se shteti ka shumë probleme, janë shumë institucione që kërkojnë buxhet nga qeveria apo mbështetje nga Kuvendi, por ne e kemi vlerësuar punën e institucionit tuaj. Do ta plotësojmë shumë shpejt atë vendin vakant. Kur them shumë shpejt, besoj se javën tjetër është në axhendën e punimeve të komisionit, dhe do t'i drejtohet seancës plenare, për t'u votuar njëri nga kandidatët që është në garë, i cili plotëson kushtet e kriteret. Është çështje ligji se kë do të mbështesin grupet parlamentare. Procedura parashikon se njëri nga kandidatët që mbështetet me 28 firma, do t'i drejtohet seancës për t'u votuar, dhe shumë shpejt do të vijë të zërë vendin në autoritet, por përsëri e them: plotësimi i atij vendi ka rëndësinë e vet, por nuk është gjithçka. Atje duhet një punë me pasion, duhet një punë që, ju vetë i promovoni ca nisma, "edhe muret kanë veshë". E pashë këtu. Shumë mirë që jeni me certifikata sigurie ju dhe Sekretariati Teknik, po kur vjen problemi, i gjithë personeli që punon aty, e që i bie në dorë dokumente të ish-Sigurimit të Shtetit, do të duhet të jetë i pajisur me certifikatë. Sepse duhet të dalin saktë përgjegjësitë se

kush i nxjerr këto dokumente. Nuk është ideja të krijojmë konfuzion në shoqëri, por t'i japim shoqërisë atë çfarë ka ndodhur gjatë pesëdhjetë vjetëve.

Duke e mbyllur, shumë faleminderit për prezencën e gjithë komisionit dhe stafit që ju drejtoni! Falënderime për punën e mirë që keni bërë! Them se rezoluta nga kolegu Shameti dhe kolegja Xhina, por edhe me kontributin e kolegëve të tjerë, do të jetë ndryshe nga vitet e tjera. Duke u bashkuar edhe me sugjerimin e kolegut Fino, lidhur me formën e mbikëqyrjes e të kontrollit parlamentar mbi institucionet që janë në fushën e përgjegjësisë së komisionit tonë, ne tashmë kemi vazhduar me disa institucione, shumë shpejt do ta ketë rashën edhe institucioni juaj, dhe ne do të vijmë e ta ndjekim në vend një ditë pune në autoritet.

Edhe njëherë shumë faleminderit dhe ditë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.04.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektvendimit “Për strategjinë e edukimit ligjor të publikut në Republikën e Shqipërisë”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Vasilika Hysi, bashkim Fino, Edmond Leka, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Elena Xhina, Edlira Bode dhe Adelina Rista

Mungojnë:

Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Adnor Shameti, Damian Gjiknuri, Alket Hyseni, dhe Tom Doshi

Të ftuar:

Rovena Pregja- Përgjegjëse Sektori në Programin e Zhvillimit për Profesionet e Lira në Ministrinë e Drejtësisë

Besnik Maho - Këshilltar i Ministrit të Drejtësisë

Artan Syziu- Përgjegjës Sektori i Studimeve Juridike dhe Analizës Ligjore në Ministrinë e Drejtësisë

Suela Jahaj - Drejtore e Kabinetit në Ministrinë e Marrëdhënieve me Parlamentin

Detiona Troka - Juriste në Ministrinë e Marrëdhënieve me Parlamentin

Blerta Xhako -Drejtore e Drejtorisë së Çështjeve Juridike të Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Vjollca Mece – përfaqësuese e Qendrës A.L.T.R.I

Eda Nocka -përfaqësuese e Qendrës A.L.T.R.I

Brikena Puka-përfaqësuese e Qendrës A.L.T.R.I

Ina Xhepa - përfaqësuese e Qendrës A.L.T.R.I

Adela Kula- përfaqësuese e Qendrës A.L.T.R.I

Edlira Agolli- përfaqësuese e OSBE-së

Blerina Fani- këshilltare ligjore në OSBE-s

Ulsi Manja – Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, që është shqyrtimi i projektvendimit “Për strategjinë e edukimit ligjor të publikut në Republikën e Shqipërisë”.

Ky është një nga projektligjet e paketës së dytë të ligjeve të reformës në drejtësi. Komisioni ynë është komision përgjegjës. Siç e dini është nismë deputeti, nismë e deputetit Shameti, ndërsa relatore e këtij projektvendimi është kolegja Vasilika Hysi.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen: nga Ministria e Drejtësisë është zoti Maho, këshilltar i ministrit të Drejtësisë; zonja Pregja, përgjegjëse sektori në Programin e Zhvillimit për Profesionet e Lira; zoti Syziu, përgjegjës i Sektorit të Studimeve Juridike dhe Analizës Ligjore.

Nga Ministria e Marrëdhënieve me Parlamentin...

(Zhurmë në sallë)

Ju lutem, qetësi, se vazhdon puna në komision. Mbaron një palë, vazhdon pala tjetër.

Nga Ministria e Marrëdhënieve me Parlamentin, zonja Suela Jahaj, drejtore e kabinetit të Ministrit

Nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, zonja Blerta Xhako, drejtore e Drejtorisë së Çështjeve Juridike.

Nga Qendra A. L. T. R. I është një grup pune. Unë nuk po i lexoj të gjithë emrat e Qendrës A. L. T. R. I, por po prezantoj vetëm zonjën Vjollca Meçe, që e kemi prezent aty.

Nga OSBE-ja është zonja Edlira Agolli, përfaqësuese, dhe zonja Blerina Fani, këshilltare ligjore.

Përpara se të fillojmë me shqyrtimin e këtij projektvendimi, do të doja të bëja një falënderim të veçantë jo vetëm për zotin Shameti si nismëtar i këtij projektvendimi, po edhe për kolegen Hysi, e cila ka gati mbi dy vjet që merret me “Strategjinë e edukimit ligjor të publikut në Republikën e Shqipërisë”. Ky është një projektvendim, që edhe pse është ndër tre projektligjet e fundit të paketës së dytë prej 27 ligjeve të reformës në drejtësi, paraqet rëndësi të madhe.

Nuk mjafton vetëm të kemi një paketë të konsoliduar të ndryshimeve kushtetuese dhe të të gjitha ligjeve të reformës në drejtësi, të cilat tashmë janë në zbatim sot, por është shumë e rëndësishme të kemi një strategji të edukimit ligjor për publikun, për ta njohur siç duhet se çfarë presupozon kjo reformë e madhe në drejtësi, që Kuvendi i Shqipërisë dhe kjo shumicë ka ndërmarrë në vitin 2014.

Sivjet jemi në vitin e pestë, është pesëvjetori i fillimit të reformës në drejtësi. Përtej të gjitha vështirësive që kjo reformë ka hasur, mua më vjen mirë që jemi në binishin e ngritjes së institucioneve të reja të drejtësisë. këtu kam parasysh Inspektorin e Lartë të Drejtësisë,

Gjykatën Kushtetuese, pse jo edhe organet e posaçme për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar në Shqipëri, dhe e kam fjalën për SPAK-un dhe Byronë Kombëtare të Hetimit.

E thënë më shkurt e më qartë, brenda shtatorit do t'i kemi në punë të gjitha organet e reja të drejtësisë, të projektuara me ndryshimet kushtetuese e me ligjet e tjera të reformës.

Zonja Hysi ka punuar me strategjinë e edukimit ligjor. Në fakt, ka qenë këmbëngulëse gjatë gjithë kohës për ta pasur këtë strategjinë e edukimit ligjor, edhe për shkak se kolegja Hysi vjen nga fusha e profesoratit, ndaj është kujdesur që studentët, opinionin publik, por edhe studiuesit, të kenë aksesin e tyre në këtë reformë madhore siç është reforma në drejtësi.

Nuk e di nëse zoti Shameti do të bëjë një prezantim të këtij projektvendimi

Adnor Shameti – Po, patjetër, me kënaqësi.

Ulsi Manja – Pastaj zonja Hysi ndo të flasë në mënyrë të detajuar.

Sot do ta votojmë këtë projektvendim “Për strategjinë e edukimit ligjor të publikut në Republikën e Shqipërisë”. Mua më vjen mirë që ky projektvendim do t'i kalojë shumë shpejt për votim seancës plenare.

Fjala është për ju, zoti Shameti!

Adnor Shameti – Faleminderit, zoti kryetar!

Strategjia për edukimin ligjor të publikut është pjesë e paketës së reformës në drejtësi, sikurse ju e thatë, dhe synon rritjen e ndërgjegjësimit ligjor të publikut në Shqipëri.

Strategjia është hartuar duke u bazuar në gjetjet dhe rekomandimet e analizës së sistemit të drejtësisë në Shqipëri, si dhe strategjisë së reformës në sistemin e drejtësisë.

-Edukimi ligjor i publikut ka si qëllim;

-Të rrisë njohuritë e publikut mbi ligjin.

-Të promovojë respektimin e ligjit.

-Të lehtësojë marrëdhëniet e qytetarit me administratën.

-Të ulë numrin e konflikteve ligjore.

-Të rrisë aksesin e qytetarëve në organet e drejtësisë dhe efikasitetin e gjykatave dhe organeve publike, duke shërbyer në forcimin e demokracisë.

Strategjia përcakton objektiva dhe përfitimet e edukimit ligjor të publikut, institucionet e organizatat, së bashku me rolet dhe përgjegjësitë e tyre, formimin e një rrjeti për edukimin ligjor të publikut, si dhe aktivitetet që duhet të përmbajë plani i veprimit për zbatimin e kësaj strategjie.

Strategjia do të zbatohet nëpërmjet një rrjeti institucionesh e organizatash, roli i të cilave ka të bëjë me ndërgjegjësimin ligjor të publikut.

Rrjeti kombëtar për edukimin ligjor të publikut do të ngrihet nga Kuvendi i Shqipërisë, dhe në përbërje të tij do të jenë përfaqësues nga institucionet qendrore, shoqëria civile, organet e sistemit të drejtësisë, si dhe përfaqësues të botës akademike.

Organet drejtuese të rrjetit do të jenë komisioni drejtues dhe bordi këshillimor. Strategjia do të shoqërohet edhe nga një plan veprimi, i cili do të hartohet nën mbikëqyrjen dhe koordinimin e Ministrisë së Drejtësisë.

Ju faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Shameti!

Fjala për ju, zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit edhe për vlerësimet!

Në fakt, nëpërmjet komisionit *ad hoc* të reformës në drejtësi, Kuvendi i Shqipërisë ndërmoi një ndër reformat më të rëndësishme, një reformë e cila ka filluar të zbatohet, dhe që në atë moment ka qenë, do të thosha, edhe largpamësia e grupit të ekspertëve të nivelit të lartë, por edhe konsultimi me shoqërinë civile, që konstatuan dhe parashikuan se kjo reformë ka nevojë për një rritje të edukimit ligjor të publikut.

Pra, nga njëra anë rritja e profesionalizmit dhe pastrimi i sistemit të drejtësisë nga korrupsioni, formimi më i mirë i gjyqtarëve e prokurorëve edhe nëpërmjet reformës që u ndërmoi për Shkollën e Magjistraturës, e nga ana tjetër edukimi ligjor i publikut, janë parë si dy shtylla shumë të rëndësishme.

Të nderuar kolegë, un do të doja të tregoja pak në lidhje me këtë proces, e dhe si transparencë por edhe si detyrim, si mirënjohje për gjithë punën që është bërë.

Një dokument paraprak është përgatitur nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë. Ka qenë një dokument jo shumë i shtjelluar, por që orientonte shtyllat bazë, në të cilat do të kalonte edukimi ligjor.

Në vitin 2016 është organizuar një seancë e gjerë konsultimi publik me shumë organizata të shoqërisë civile dhe me koalicionin “Drejtësi për të gjithë”.

Ndjesë nëse mund të harroj dikë tjetër, por ka qenë një konsultim shumë i gjerë, me përfaqësues të institucioneve qendrore e vendore, me institucionet e pavarura, duke filluar që me Avokatin e Popullit, Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Komisionerin për Mosdiskriminimin, universitetet e të tjera. në përfundim u arrit në dokument, për të cilin u mendua se ka nevojë të shtjelohet më shumë, dhe Kuvendi i Shqipërisë nuk mund ta bënte vetë, nuk mund të ndërmernte e të shkruante një strategji.

Në këtë kuadër, iu kërkua organizatave të shoqërisë civile të angazhuara në rrjetin e konsultimit publik të reformës në drejtësi, që të asistonin Komisionin e Ligjeve në zhvillimin e mëtejshëm të kësaj strategjie dhe në konsultimin publik në gjithë territorin e Shqipërisë.

Unë do të doja të sillja në vëmendjen tuaj, atë që me të drejtë e përmendi kryetari i komisionit, që në kuadër të shtatë shtyllave të reformës në drejtësi, në një nga këto shtylla është theksuar ose janë analizuar në mënyrë të detajuar pikat e dobëta që ka edukimi ligjor i publikut.

Shpesh qytetarët nuk marrin shërbime dhe nuk gëzojnë të drejtat e tyre, sepse nuk i njohin dhe nuk dinë si t'i ushtrojnë ato. Këtu nuk do të doja t'i përmendja konkretisht se cilat janë gjetjet e analizës së sistemit të drejtësisë në Shqipëri dhe çfarë thuhet në planin e veprimit, por i është lënë detyrë pikërisht këtij komisioni dhe Kuvendit, që të miratojë strategjinë e edukimit ligjor.

Forma se si do të realizohet edukimi ligjor i publikut janë të ndryshme: me informim, përgatitje, publikim, shpërndarje informacionesh, ndërgjegjësim, përdorim i fushatave mediatike, përdorim më të gjerë të medieve, por mbi të gjitha, një zë i rëndësishëm jua vetë institucionet shtetërore.

Projektstrategjia e edukimit ligjor ka kaluar një proces të gjerë konsultimi publik. Në lidhje me këtë, zoti kryetar, do të doja që pas fjalës sime, t'ia kalonim fjalën zonjës Eda Noçka, e cila së bashku me rrjetin e organizatave të shoqërisë civile, ka ndjekur gjithë procesin e konsultimit publik. Është model, do të thosha, ka një numër shumë të gjerë të konsultimit publik. Janë mbi 559 organizata, donatorë, ambasada, bashki, ministri, institucione, që janë konsultuar dhe që kanë shprehur mendimet dhe sugjerimet e tyre. Në këtë proces ju keni një dokument, i cili është përcjellë nga shërbimet e komisionit, ku ka një relacion të detajuar në lidhje me propozimet që janë bërë për draftin final të kësaj projektstrategjie: marrja ose jo në konsideratë e këtyre rekomandimeve, pse janë marrë, në disa raste pse janë marrë në mënyrë jo të plotë, ose çfarë sugjerohet.

Gjithashtu, të nderuar kolegë, do të doja të theksoja shumë shkurt se strategjia ka gjashtë krerë. Në kreun e parë përshkruhet metodologjia e hartimit të strategjisë së edukimit ligjor, metodologji gjithëpërfshirëse, e cila ka karakterizuar dhe reformën në drejtësi. Është shtrirë në të gjithë territorin e vendit, sidomos në bashkitë kryesore.

Në kreun e dytë jepet një vështrim analitik i situatës së edukimit ligjor. Këtu bazohet jo vetëm në analizën që ka bërë grupi i ekspertëve të nivelit të lartë, pra te analiza e sistemit, por edhe në konsultimin e mëtejshëm që është bërë. Do të doja të theksoja se varianti që ne kemi, është variant i përmirësuar rrënjësisht dhe i konsultuar në mënyrë sistematike. Kanë ardhur disa variante, sepse edhe vetë legjislati ka qenë në proces ndryshimi e përmirësimi.

Plus, ne kemi marrë komente e sugjerime edhe nga institucionet e reja të drejtësisë, që janë ngritur. Është gjë shumë e mirë që institucionet e reja kanë kërkuar të dëgjoen, si Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Ministria e Drejtësisë ka evoluar me strategjitë e me zbatimin e reformës. Për rrjedhojë, nuk mund të anashkalohen. Nga ana tjetër, kemi pasur një proces shumë intensiv dhe kontrollit parlamentar edhe vetë në Kuvend, çka është kërkuar që edhe kjo të reflektohet.

Në kreun e tretë janë vizioni dhe objektivat strategjike; në kreun e katërt janë politikat që do të ndërmerren për të përmbushur këtë vizion dhe këtë strategji; në kreun e pestë janë burimet financiare dhe në kreun e gjashtë janë llogaridhënia, monitorimi dhe analiza e vlerësimit. Unë nuk dua të flas për procesin e hartimit të strategjisë, pasi këtë do t'ua lë atyre që u takon dhe që e meritojnë, pikërisht shoqërisë civile, pra do t'ua lë grupit të të gjitha organizatave të shoqërisë civile që janë të pranishëm, por edhe atyre që nuk janë të pranishëm.

Më lejoni të falënderoj të gjitha institucionet e pavarura kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj, të cilat raportojnë në Kuvend dhe kanë qenë aktive, si: OSBE-në, EURALIUS –it dhe të gjitha organizatat e tjera. Meqenëse këtu kemi edhe një konsultim shumë të gjerë, dua të bëj një falënderim të veçantë për Këshillin e Ministrave dhe ministrinë përkatëse, që kanë dhënë sugjerime.

Të nderuar kolegë, do të doja të ndalesha te kërkrat III, IV dhe V, sepse janë shumë të rëndësishëm. Unë kam dy apo tri komente lidhur me rolin që duhet të ketë Kuvendi në këtë proces, për të cilin ka pasur mendime ndryshe nga drafti që është paraqitur në komision. Unë nuk mund ta merrja të drejtën për ta ndryshuar pa pasur një konsultim dhe diskutim midis nesh.

Vizioni që synohet të arrihet nëpërmjet strategjisë së edukimit ligjor është pikërisht për të pasur qytetarë më të ndërgjegjësuar për rëndësinë e njohjes së ligjit, të drejtave dhe detyrimet e tyre bazuar në nevojat specifike që kanë kategori të caktuara shoqërore dhe në nxitjen e aktivizimit qytetar për forcimin e shtetit të së drejtës.

Se sa e rëndësishme është kjo detyrë nuk ka nevojë ta theksoj, por është një detyrim që na rrjedh nga MSA-ja, nga plani i veprimit që kemi në kuadër të integritit evropian, si dhe është një detyrim në kuadër të Planit Kombëtar të Integritit Evropian të miratuar nga Këshilli i Ministrave 2017-2020 dhe angazhimit që ka Kuvendi i Shqipërisë për rritjen e rolit të tij në forcimin e shtetit të së drejtës, respektimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, si dhe rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve.

Objektivat strategjike janë 4:

Objektivi i parë është përmirësimi, organizmi dhe funksionimi institucional në ofrimin e edukimit ligjor të publikut. Me të drejtë qytetarët mund të pyesin: “Nuk ka edukim ligjor deri

më sot”? Përgjigjja është: “Ka, por bëhet në mënyrë të copëzuar në secilin institucion brenda targetit, funksionit ose juridiksionit të tij”. Të them të drejtën, shpeshherë në parlament ne jemi treguar më të vëmendshëm për t’i parë ligjet nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut jo vetëm në komisionin tonë, por edhe në shumë komisione të tjera, madje edhe nëpërmjet mekanizmit ndërinstitutional, që është krijuar për të monitoruar zbatimin sistematik të rekomandimeve të institucioneve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj. Megjithatë, kemi një sërë aktesh nënligjore që nxjerr qeveria, ose urdhra dhe udhëzime që nxjerrin ministrat, të cilët kanë nevojë të jenë në përputhje dhe të respektojnë standardet jo vetëm Kushtetutën dhe ligjin, por të kenë parasysh edhe nevojën për të ofruar një gjuhë të thjeshtë, të qartë, pa ekuivokë për qytetarët, në mënyrë që i gjithë publiku, përfituesit t’i kuptojnë ligjet dhe t’i respektojnë ato, por dhe të përfitojnë të drejtat që parashikojnë ligjet. Në kuadër të këtij objekti lind një detyrim që duhen riparë të gjitha aktet ligjore, nënligjore dhe ligjet për t’i përfruar ato me standardet dhe për t’i dhënë qytetarit një informim ose edukim ligjor sa më të mirë. Në këtë kuadër për ne si Komision i Ligjeve ka një detyrim, që ligjet duhet t’i shkruajmë qartë saktë, pastër, me një gjuhë të thjeshtë, në mënyrë që të mos krijohen probleme në zbatimin e tyre.

Së dyti, mund të kemi ligje shumë të mira, por ligjet kanë nevojë për një faturë financiare, që të zbatohen. Ne nuk duhet të presim gjithmonë buxhet nga donatorët. Pra, kërkohet një rritje e sensibilizimit edhe nga institucionet qendrore. Unë e kuptoj se miratimi i kësaj strategjie nga Kuvendi dhe hartimi më pas i planit të veprimit do të jetë një barrë për Ministrinë e Drejtësisë, por besoj se edhe Kuvendi i Shqipërisë do të japë të gjithë mbështetjen për të pasur një buxhet të kënaqshëm.

Objekti i dytë strategjik është garantimi dhe forcimi i bashkëpunimit efektiv ndërinstitutional në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor për realizimin e edukimit ligjor. Zoti Fino është njohës shumë i mirë i organeve të qeverisjes vendore dhe bashkë me zotin Çuçi, kur kanë hartuar ligjin për reformën territoriale administrative dhe ligjin për organet e vetëqeverisjes, i kanë dhënë një zë të veçantë transparencës së organeve të qeverisjes vendore, ofrimit të shërbimeve, informimit të qytetarëve e të tjerë.

Në kuadër të diskutimit të strategjisë dhe përgatitjes së këtij relacioni më është dashur t’i rikthehem edhe ligjit të qeverisjes vendore. Me të vërtetë është një problem shumë i madh, është një ligj shumë i mirë, por që ka nevojë të zbatohet dhe të monitorohet nga Kuvendi. Pikërisht në këtë strategji i jepet shumë rëndësi transparencës së organeve të qeverisjes vendore, informimit të qytetarëve për shërbime, me një gjuhë të thjeshtë, të qartë dhe të kuptueshme.

Në këtë kuadër, në objektivin strategjik numër 2 u jepet rëndësi memorandumeve të bashkëpunimit, planit të komunikimit në nivel qendror, por sidomos në nivel vendor. Vetë strategjia prek një nivel të funksionimit dhe të transparencës në organet e qeverisjes vendore. Të jemi të sigurtë ka një zhvillim shumë pozitiv falë bashkëpunimit dhe kontributit që japin organizatat e shoqërisë civile, vetë sensibiliteti që kanë bashkitë, por ka nevojë për më shumë.

Të nderuar kolegë, ne kemi një nënkomision pranë Komisionit të Ligjeve, është Nënkomisioni që drejton zoti Fino Për Organet e Qeverisjes Vendore, i cili mund të kontribuojë për të parë se si realizohet informimi, transparenca, konsultimi publik dhe edukimi ligjor i qytetarëve në nivel vendor. Nga ana tjetër, ka edhe një sërë institucioneve, që me të drejtë Komisioneri për të Drejtën e Informimit na e ka nxjerrë në pah në raportin e viti 2018, që nuk janë aq transparente sa duhet dhe që kanë nevojë për përmirësime, sepse sa më transparentë, aq më mirë do t'i gëzojnë të drejta e tyre qytetarët.

Objektivi i tretë strategjik është sigurimi i performancës efektive, eficiente i institucioneve publike dhe të pavarura, medieve dhe shoqërisë civile. Këtu ka rëndësi jo vetëm trajnimi, përmirësimi i kurrikulave të hartuara, rishikimi i tyre, por edhe trajnimi i përfaqësuesve të institucioneve të administratës publike dhe të pavarura, pse jo edhe të medieve, që shpesh, nëpërmjet transmetimeve dhe informimit të qytetarëve, kanë nevojë të përmirësojnë procesin e informimit dhe sensibilizimit të publikut.

Objektivi i katërt strategjik është ndërgjegjësimi i publikut për rëndësinë e njohjes së ligjit dhe të drejtave bazuar në nevojat specifike. Këtu ka një sërë grupesh sociale, që u kushtohet fokus i veçantë (nuk janë vetëm gratë, fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, LGBT-ja, nuk janë vetëm viktimat e dhunës në familje, viktimat e trafikimit), siç janë: kategoria e të rinjve, minoritetet dhe shtresat e tjera.

Të nderuar kolegë këto janë 4 objektivat strategjike, që kërkojnë ndërmarrjen e disa politikave:

Së pari, është përmirësimi i legjislacionit.

Së dyti, është rritja e vazhdueshme e burimeve financiare dhe burimeve njerëzore të mirëtrajnuara, të përgjegjshme, të ndërgjegjshme për të kuptuar se sa i rëndësishëm është ofrimi i shërbimeve, duke respektuar liritë dhe të drejtat njeriut, por mbi të gjitha qytetarët kanë të drejtë të informohen për shërbimet, dhe të mos përcillen nga një derë e një institucioni në një institucion tjetër.

Të nderuar kolegë, unë kërkoj të di edhe mendimin tuaj lidhur me një propozim që bëhet. Kërkohet të ngrihet rrjeti kombëtar për edukimin ligjor të publikut pranë Kuvendit të Shqipërisë, i cili duhet të koordinojë dhe të bashkërendojë iniciativat e edukimit ligjor të

publikut në nivel kombëtar dhe rajonal. Nëse doni të dini mendimin tim, unë jam skeptike që të jetë Kuvendi i Shqipërisë, jo se Kuvendi nuk e ka përgjegjësinë të monitorojë impaktin ose ndikimin e ligjeve dhe strategjive, por ne kemi një sërë mekanizmash të brendshëm, institucionalë, që e kanë për detyrë të monitorojnë strategjitë dhe ndikimin e ligjeve. Pra, secili komision dhe nënkomision parlamentar, brenda mandatit të tyre, e ka për detyrë të kontrollojë ligjet që ka miratuar dhe që janë në juridiksionin e këtij komisioni.

Së dyti, ne kemi një Shërbim Monitorimi, i cili monitoron të gjitha institucionet e pavarura kushtetuese ose të krijuara me ligj që raportojnë në Kuvend.

Së treti, kemi një mekanizëm ndërinstitutional, i cili ndjek në mënyrë sistematike zbatimin e rekomandimeve të institucioneve të pavarura. Ju e dini që shumica e institucioneve të pavarura që raportojnë në Kuvend kanë si detyrë dhe përgjegjësi edukimin ligjor të qytetarëve. Në pjesë të procesit të monitorimit të tyre e kemi edhe këtë aspekt. Nga ana tjetër, ju mund të mendoni se ky mekanizëm duhet të ngrihet i përfaqësuar nga një sërë institucionesh, si: Presidenti, Kuvendi i Shqipërisë, Kryeministri, Avokati i Popullit, ministritë apo institucionet e pavarura, të cilat me propozim të EURALIUS-it janë shtuar, siç janë : KLGJ-ja, KLP-ja, Shkolla e Magjistraturës e të tjerë.

Ndoshta një sugjerim mund të ishte që, me vendim të Këshillit të Ministrave, të ngrihet ky rrjet ndërinstitutional, ku Kuvendi të ketë përfaqësinë e tij, por të mos dubloheshin mekanizmat që ka Kuvendi. Këtë nuk e bëj për të shmangur përgjegjësitë dhe detyrimet që ka Kuvendi në monitorimin e strategjisë, por nga 31 institucione që përmenden si pjesë e rrjetit kombëtar të edukimit ligjor, shumica kanë të bëjnë me ekzekutivin dhe një pjesë e mirë e këtyre institucioneve që raportojnë në Kuvend kanë të bëjnë me shoqërinë civile, me universitetet, me fakultetet që kanë klinika apo kanë të bëjnë me bashki. Duke qenë se edhe qeveria do të miratojë planin e veprimit dhe Ministria e Drejtësisë do të monitorojë zbatimin e planit të veprimit, do të ishte më mirë që me një VKM të miratohej ngritja e këtij rrjeti. Ashtu sikurse ju e keni përmendur, këtu edhe rregullat e organizimit dhe funksionimit të përcaktoheshin me këtë VKM, pa mohuar rolin që ka Kuvendi, nëpërmjet instrumenteve të kontrollit parlamentar. Në këtë mënyrë e bëjmë edhe Këshillin e Ministrave më të angazhuar. Ne kemi edhe një ministre të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, që mund të kërkojë më shumë llogari dhe në mënyrë dinamike mund t'u kërkojë ministrive dhe institucioneve informacion, por edhe të parashikojë buxhetet e mjaftueshme për mbështetjen e planeve të veprimit.

Lidhur me rolin e Ministrisë së Drejtësisë në hartimin e planit të veprimit, unë jam dakord që të bëhet brenda një 6-mujori nga miratimi, jo brenda muajit qershor, se është e pamundur. Meqenëse këtu është edhe përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë, ai mund të

shprehet vetë për këtë gjë, por mendoj se Ministria e Drejtësisë e ka detyrë funksionale të marrë masa për informimin dhe edukimin e qytetarëve. Gjithashtu, kontrollon edhe profesionet e lira, ka lidhje me një sërë institucionesh të tjera, si me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokurorin e Përgjithshëm, raporton në Kuvend për të sjellë rekomandime për parandalimin e luftës kundër kriminalitetit e kështu me radhë.

Një propozim tjetër është se duhet të ketë raporte periodike 6- mujore dhe 1-vjeçare lidhur me zbatimin e kësaj strategjie. Kjo strategji ka nevojë të monitorohet në mënyrë sistematike, por duke qenë se unë propozoj që ky rrjet të ngrihet me një VKM, atëherë raportimet mund të jenë më të shpeshta se 6 muaj. Pra, po të ishin në Kuvend do të bënte sens 6 muaj, por raportimet këtu duhet të jenë më të shpeshta. Mund të ketë 3 raportime, jo më pak se 2 herë, duke i dhënë mundësi sensibilizimit dhe ndjekjes së veprimtarisë dhe zbatimit të kësaj strategjie në mënyrë sistematike.

Zoti kryetar, unë dua të falënderoj të gjithë ekspertët që kanë punuar për hartimin e draftit final të kësaj strategjie, si edhe për dy dokumente shitesë që janë: tabela e treguesve të monitorimit dhe pasaporta e indikatorëve. Ky është rasti i dytë, që Komisioni i Ligjeve shqyrton (hera e parë ishte ligji i nxitjes së punësimit), një pasaportë e indikatorëve që do të na japë mundësinë neve dhe të gjithë mekanizmave monitorues për të ndjekur zbatimin e kësaj strategjie.

Prandaj, të nderuar kolegë, pa dashur të zgjatem, unë dua të di mendimin tuaj për rolin e Kuvendit në menaxhimin e këtij rrjeti.

Së dyti, në projektstrategjinë që keni para unë kam bërë disa përmirësime të teknikës legislative, duke shmangur përsëritje në ndonjë paragraf, disa saktësime, siç është ligji i ri i kadastrës, disa rregullime në lidhje me analizën që ju keni bërë bazuar edhe në shifrat ose raportet e reja që ka paraqitur Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të cilat mund t'ua nis me email në qoftë se dëshironi para se t'i kalojnë seancës plenare, në mënyrë që të mos lexoj çdo fjali apo çdo paragraf ndërhyrjet e teknikës legislative.

Faleminderit!

Ulsi Manja- Faleminderit, zonja Hysi!

Unë do t'i lutem përfaqësuesit të Ministrisë së Drejtësisë që të thotë shkurtimisht opinionin e tij në lidhje me këto dokumente strategjike dhe pastaj kolegët do të bëjnë pyetje, diskutime dhe sugjerime konkrete për projektvendimin.

Po, zoti Maho.

Besnik Maho – Faleminderit, zoti Manja!

Falënderoj edhe zonjën Hysi për shpjegimin hollësishëm në lidhje me strategjinë për edukimin ligjor të publikut.

Ministria e Drejtësisë është dakord në parim me këtë strategji, e cila është shumë e nevojshme për t'u miratuar pasi zgjidh një sërë çështjesh problematike, sikurse është ajo e edukimit të rinjve në gjimnaze.

Një nga qëllimet tona është që të fusim në kurikulat e gjimnazeve një edukim të shëndoshë, për një sërë çështjesh të rëndësishme siç janë Kushtetuta, ligjet bazë, Kodi i Familjes Civile e kështu me radhë. Unë mendoj se është e rëndësishme t'u japim fëmijëve një orientim të shëndoshë që ata të dinë se çfarë duhet të bëjnë dhe çfarë nuk duhet të bëjnë. Gjithashtu, një gjë shumë e rëndësishme do të ishte dhe orientimi i profesorëve për edukimin e mjaftueshëm, të cilët duhet t'i edukojnë fëmijët në këtë drejtim, sikurse strategjia e parashikon.

Këtë rol promotor nuk duhet ta kenë vetëm fakultetet e drejtësisë, që janë baza për edukimin e qytetarëve, por edhe fakultetet e tjera, të cilat duhet të fusin lëndë të përgjithshme, sepse po të shohim në kurikulat e tyre studimore, meqenëse unë vij nga jeta akademike, ka me dhjetëra lëndë të karakterit psikologjiko-social dhe ka shumë pak hapësirë për lëndë që u kushtohen drejtpërsëdrejti akteve normative, sikurse është Kushtetuta dhe ligjeve kryesore.

Unë mendoj se njohuri të tilla të përgjithshme duhet të shikohen me përparësi jo vetëm nga Ministria e Drejtësisë, por edhe nga Ministria e Arsimit dhe i gjithë korpusi institucional që parashikohet në këtë strategji, duhet të luajnë rolin që i takon.

Ka shumë elemente pozitive, por unë nuk dua të zgjatem, sepse u thanë nga kolegët, por ajo që është shumë e rëndësishme për t'u thënë është se në këtë strategji janë të përfshirë 31 institucione dhe Ministria e Drejtësisë është një nga ata që do të ketë barrën e monitorimit. Unë nuk jam kundër monitorimit, por jam drejt ndarjes së përgjegjësisë dhe të drejtave që duhet të ketë secili institucion i përfshirë në këtë rrjet.

Në bërjen e planit të veprimit, ku do të preken edhe aktet ligjore dhe nënligjore, duhet të përcaktohet specifikisht se çfarë duhet të bëjnë ministritë, organet e pushtetit lokal, institucionet publike të pavarura, KLGJ-ja, KLP-ja dhe pushtetet e tjera vendore. Është shumë e thjeshtë t'i drejtohesh dhe t'i kërkohsh informacion secilit institucion, me të cilët je i barabartë, por për të dhënë informacion në lidhje me gjithë veprimtarinë e edukimit ligjor të shtresave dhe grupeve shoqërore që i përkasin, ata duhet ta kenë nga ligji i posaçëm nga i cili varen, por edhe nga aktet nënligjore.

Në vijimësi të kësaj strategjie aktet ligjore dhe nënligjore ne do t'i shohim në vazhdimësi, por duhet të mirëpërcaktohen detyrimet e secilit institucion të përfshirë në këtë

rrjet prej 31 institucionesh. Pra, Ministria e Drejtësisë nuk duhet parë si një organ superior mbi gjithë institucionet e tjera, por të drejtat e detyrimit për t'u përgjigjur dhe për të raportuar duhet ta shikojnë nga ana e ligjit.

Së dyti, sikurse e tha edhe zonja Hysi, është shumë e nevojshme që burimet financiare të mos shikohen vetëm nga donatorët për zbatimin e kësaj projektstrategjie, por të shikohen edhe nga buxheti i shtetit. Ministria e Drejtësisë ka nevojë për më shumë burime njerëzore, punonjës që do të merren me monitorimin dhe informacionin që do ta përcjellin në komisionin që do të ngrihet në parlament apo në një institucion tjetër, pra si të parashikohet. Pra duhen burime njerëzore, fonde financiare për kancelari dhe shumë gjëra të tjera me qëllim që Ministria e Drejtësisë të mos mbajë një barrë përtej funksioneve që ajo ka. Ne nuk jemi për përjashtimin e kësaj barre që do të mbajmë, por duhen që të rritet aksesin dhe mundësia për ta monitoruar.

Në vija të përgjithshme ky është qëndrimi që ne mbajmë. Ne e përkrahim këtë nismë dhe do të jemi bashkëpunëtorë në të gjitha instrumentet e tjera që do të miratohen.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Maho!

A keni ndonjë gjë për të shtuar?

Po, zonja Noçka.

Eda Noçka – Jam pjesë e grupit të punës së qendrës “Altri” dhe përfaqësoj koalicionin “Drejtësi për të gjithë”.

Së pari, falënderojmë grupin e punës për punën që ka bërë në hartimin dhe përmirësimin e projektstrategjisë.

Ky projekt ka filluar që në vitin 2017 me një proces të gjatë konsultimi, ku janë përfshirë një sërë aktorësh. Versioni i parë i strategjisë i është paraqitur Kuvendit në dhjetor të vitit 2017, i cili është një version i konsultuar me Departamentin për Zhvillimin dhe Mirëqeverisjen në Kryeministri, pra departamentin e strategjive. Më pas ka vijuar një proces të gjerë konsultimi me institucionet publike, nëpërmjet konsultimit zyrtar të projektstrategjisë dhe konsultimeve publike në të gjithë vendin.

Versioni i rishikuar, në të cilin janë reflektuar komentet e ardhura nga një sërë institucionesh, i është nënshtruar sërish konsultimit me Ministrinë e Drejtësisë dhe me Departamentin për Zhvillimin dhe Mirëqeverisje.

Për sa i përket procesit të monitorimit, duke marrë në konsideratë që projektstrategjia është konceptuar të miratohet nga Kuvendi dhe plani i veprimit nga Ministria e Drejtësisë, atëherë grupi i punës propozoi një monitorim të dyfishtë, pra në dy nivele. Një monitorim nëpërmjet rrjetit kombëtar të edukimit ligjor të publikut, e cila do të monitoronte strategjinë,

pra aktin e miratuar nga Kuvendi dhe monitorimin nga Ministria e Drejtësisë të planit të veprimit që propozohet të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Mekanizmat e monitorimit kanë parashikuar edhe të gjithë mundësitë e bashkëpunimit, duke ndarë qartë përgjegjësisë që ka rrjeti kombëtar i edukimit ligjor të publikut në monitorim dhe monitorimet nga Ministria e Drejtësisë, e cila duhet të monitorojë planin e veprimit dhe të raportojë në mënyrë të rregullt pranë rrjetit dhe pranë Komisionit për Çështjet Ligjore.

Monitorimi është parashikuar të bëhet në faza 6-mujore dhe 1-vjeçare. Ky propozimi ka ardhur nga Departamenti për Zhvillimin dhe Mirëqeverisjen në Kryeministri, duke marrë standardin që ndiqet aktualisht për raportimin në kuadër të strategjive sektoriale dhe ndërsektoriale të miratuara nga qeveria.

Anëtarët e rrjetit kanë përgjegjësi të mirëpërcaktuara, që burojnë nga kuadri ligjor në fuqi.

Në kapitullin e dytë të projektstrategjisë, është bërë një analizë e hollësishme për të gjithë institucionet dhe kuadrin ligjor që ngarkon institucionet me përgjegjësi të informimit dhe edukimit ligjor të publikut. Rrjeti përbëhet nga 37 anëtarë, të cilët kanë përgjegjësi që buron nga kuadri ligjor aktual në fuqi të këtyre institucioneve.

Për sa i përket buxhetit, aktualisht është hartuar një plan veprimi nga grupi i punës së koalicionit, i cili është nënshtruar, gjithashtu, procesit të gjatë të konsultimit, që shoqërohet me kosto nga buxheti i shtetit, duke marrë në konsideratë që të punohet në drejtim të shfrytëzimit edhe të burimeve njerëzore ekzistuese. Megjithatë, ky plan veprimi ka nevojë që të shqyrtohet dhe të trajtohet nga ministritë përgjegjëse, siç është Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe nga Kryeministria.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Zoti Fino e ka fjalën.

Bashkim Fino – Më pëlqeu e gjithë rezymeja që bënë të ftuarit dhe zonja Hysi dhe i falënderoj.

Ne po bëjmë një strategji për edukimin ligjor të publikut në Republikën e Shqipërisë. Në momentin që e bëjmë ne si Kuvend, do të thotë që duhet të marrim mendimin e të gjithëve. Unë ju dëgjova me shumë kujdes dhe mbajta shënime, por ne do të ngremë një nukël pranë Kuvendit ose do të jetë Drejtoria e Monitorimit që është në Kuvend, e cila do ta monitorojë këtë gjë sepse përfshihen të gjithë aktorët dhe faktorët që ndikojnë në këtë strategji kanë të bëjnë, duke filluar nga Presidenti i Republikës dhe deri te struktura më e vogël. Unë jam për

krijimin e një strategjie model, në formë edhe në përmbajtje dhe të mos jetë vetëm në një copë letër.

Po të shikosh strategjinë e Autoritetit për Informimin mbi dokumentet është vërtetë dinjitoze, pra edhe ne duhet të bëjmë një strategji vërtetë dinjitoze. E para.

E dyta, që kam për strategjinë. Në momentin që do të bëjmë këtë gjë, do të ngremë një nukël, e cila duhet trajtuar me strategji, përveç Drejtorisë së Monitorimit, e cila duhet të mbledhet disa herë gjatë vitit për të raportuar dhe për të ndjerë institucionet e vartësisë ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk ka nevojë. Unë dua që të bëhet bukur, në formë libri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, por duhet ta bëjmë moderne.

Zonja Hysi, problemi që kam është: në këtë strategji që ne do të bëjmë, a do të kemi një lloj nukli, i cili do të raportojë më shumë se një herë, e të tjera? Pra a do të krijohet kjo gjë, sepse kjo lidhet edhe me pyetjen tjetër që kam?

Në këtë strategji a duhet të vendosim afate konkrete kohore? Unë mendoj se duhet të vendosim, sepse janë gjithë këto institucione në funksion të kësaj strategjie. Institucioni ynë është institucioni më i lartë në momentin që po bëjmë këtë strategji.

E treta, mbasi të vendosim afate konkrete kohore për të gjithë aktorët, a duhet të vendosim një buxhet ekstra? Unë jam për një buxhet ekstra, nuk jam për buxhetin që ka sot Kuvendi. Pra, përveç donatorëve, duhet të kemi edhe një buxhet ekstra për këtë strategji në momentin që ngremë këtë strukturë pranë Kuvendit të Shqipërisë, e cila do të jetë e pavarur nga të gjitha institucionet ligjzbatuese.

Mendimi im, nga pikëpamja ekonomike, është që në fillim të vendosim këto pika, pra se si do ta trajtojmë këtë strategji dhe pastaj të hyjmë në pjesët teknike, siç thatë edhe ju, në shkolla dhe fakultete e të tjera për edukimin e nxënësve. Pra me vendosjen e pikave ne orientojmë strategjinë me gjithë atë që thatë ju, duke vënë afate konkrete, me buxhet konkret edhe me një nukël monitorimi, nga i cili raportohet.

Ky nukël monitorimi a duhet të ketë një raportim më të gjerë në Komisionin e Ligjeve, sepse ka të bëjë me strategjinë e edukimit ligjor? Unë jam dakord, sepse në shkolla nuk kemi një kurikulum të strategjisë ligjore.

Sot në Shqipëri kemi shumë juristë, kur thotë ndonjëherë edhe Kryeministri Rama: “Edhe kamerierët janë me diplomë juridiku”. Pa ofenduar pozicionin e juristit, por dua të them që ka shumë juristë dhe nuk dinë se çfarë ligji është nxjerrë dhe çfarë ligji është në funksion e

të tjera. Por edhe ne që jemi në Komisionin e Ligjeve e kemi të vështirë t'i mbajmë mend të gjitha dhe jo më pjesa tjetër që ka të bëjë me pjesën akademike.

Unë mendoj se po ta organizojmë kështu do ta bëjmë më të fortë. Pra, dua që të bëhet një strategji që të mos ngelet në letër, por të bëhet një libër i bukur, ku të jemi korrekt me BE-në, me veten tonë dhe me reformën në drejtësi, që edhe këtë ligj e bëmë. Pra të mos lihet në sirtar dhe po u kujtua Drejtoria e Monitorimit, për të cilën unë kam shumë vërejtje, pra për atë drejtor që kemi këtu, pavarësisht punës që mund të bëjë, dhe bën, sepse justifikon edhe pagën që merr, bën ndonjë material apo ndonjë gjë për ne këtu, por unë e kuptoj ndryshe monitorimin, jo thjesht të bëjë një material për mua si deputet, po që duhet të jetë *non stop* duke u dhënë informacion të jashtëzakonshëm deputetit dhe institucioneve të tjera. Po bëmë një strategji të fortë, të cilën do ta zbatojmë dhe të kërkojmë llogari mbi to, me fond dhe me një nukël më vete, jo nga Drejtoria e Monitorimit, besoj se do të bëjmë diçka të re, që ka strategjinë e edukimit ligjor për brezin e ri në Republikën e Shqipërisë. Ky është i gjithë merakun që kam unë.

E preku pak edhe Vasilika të pjesa pushtetit vendor. Ne vërtet e kemi bërë të komunikueshëm pushtetin vendor, por ai ka plotësisht të drejtë të veprojë në edukimin ligjor të njerëzve që ka në çdo njësi vendore për strategji të caktuara që vendosim ne apo dikastere të ndryshme, gjë që është e shkëputur, sepse çdo njeri shikon pozicionin e punës që ka në bashki dhe nuk do t'ia dijë për të tjerat. Nëse ne do të kemi këtë nukël, do të shkojmë në çdo bashki. Pra, do të shkojë ky nukël në çdo bashki, që do të ketë një fond të caktuar, dhe do të interesohet bashkë me aktorët dhe faktorët e tjerë të shoqërisë civile, të ministrive apo të Kryeministrit, për të bërë të mundur strategjinë e edukimit ligjor të publikut, por natyrisht duke u drejtuar nga Kuvendi i Shqipërisë, meqenëse ne jemi Republikë parlamentare dhe kjo është një strategji që duam të bëjmë për këtë edukim.

I thashë të gjitha këto duke përmbledhur një sugjerim, që të mos flasim më në sensin që duhet t'i rregullojmë strategjitë, t'i vëmë piketat, siç duhet, dhe të vendosim veton, zoti kryetar, sepse ai mund të thotë: “nuk kam lekë”, ndaj do të kemi fond buxheti për këtë gjë, e para.

E dyta, do ta ngremë strukturën që të drejtojë këtë strategji pranë kuvendit të Shqipërisë, me 5 apo me 10, do ta shikojmë me qetësi. Kjo strukturë do të raportojë te Komisioni i Ligjeve, që është një komision i rëndësishëm, i barabartë me aktorët dhe faktorët e tjerë që ka, për punën që kanë bërë në çdo bashki, në çdo institucion e të tjera, që nga Presidenti, tek institucionet e tjera. Kështu e kuptoj unë strategjinë, nëse do të bëjmë një të tillë,

që ta drejtojmë dhe ta monitorojmë ne. Në të kundërt, nëse do të bëjmë një strategji që ta drejtojnë dhe monitorojnë ata dhe ne thjesht ta miratojmë, është shumë mirë kështu siç është.

Ulsi Manja – Kur hymë në fazën e diskutimit të kësaj draftstrategjie, e kuptojmë edhe atë që duam të bëjmë. Unë kam pasur debat të vazhdueshëm me zonjën Hysi, nëse Kuvendi i ka kapacitetet e duhura për të hartuar dhe monitoruar strategji, sepse nuk mjafton të kemi thjesht një dokument strategjik të rëndësishëm të këtij lloji, të shkruar bukur, por lidhet edhe me kreun e pestë, për burimet financiare, në të kundërt do të ngelet në letër. Është fat që në Shqipëri nuk kemi vuajtur ndonjëherë për strategji dhe për ligje, por problemi është zbatimi.

Pyetja që kam pasur vazhdimisht ka qenë: dakord, do ta hartojmë këtë draftstrategji me këtë formë, siç paraqitet, por i kemi ne mundësitë më pas për ta monitoruar këtë strategji? Buxhetohet? Funksionon? Ka shkuar mesazhi i asaj që kemi dashur të bëhet me këtë strategji te edukimi ligjor i qytetarëve? Ndaj vij te pyetja që shtroi kolegu Fino, ta ndajmë këtë gjë. Zoti Maho tha: “në dy nivele”. Pra, një monitorim i strategjisë kombëtare dhe një monitorim i planit të veprimit. Sigurisht, ky është një dokument strategjik, që prapa do të ketë planin e veprimit bashkë me buxhetin. Jam shumë dakord që Ministria e Drejtësisë duhet të jetë motori i monitorimit të planit të veprimit, sepse lekët i marrim te godina tjetër, nuk i kemi këtu. Kuvendi i Shqipërisë buxhetohet njësoj si të gjitha institucionet e tjera.

A jam unë dakord që Kuvendi të luajë këtë rol? Po, jam absolutisht dakord që të ketë një nukël të fortë në Kuvend për monitorimin e strategjisë, si zbatohet, por jo të marrë rolin kordinues dhe monitorues të 32 agjencive që përfshihen këtu. Nuk e bën dot, mendoj unë, sado të fortë ta kemi ne Drejtorinë e Monitorimit të Institucioneve të Pavarura. Megjithatë, nëse do ta vendosim Kuvendin në qendër të kësaj strukture koordinimi dhe Ministrinë e Drejtësisë për planin e veprimit, patjetër që raportimi do të vijë në Komisionin e Ligjeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër që do të vish të raportosh këtu. Kjo ndoshta është një përgjegjësi shtesë për komisioni tonë, por nëse zonja Hysi thotë: po, Kuvendi duhet ta luajë këtë rol për strategjinë e edukimit ligjor si institucioni që do ta monitorojë dhe kordinojë, duhet të jemi pak më të qartë se si do ta bëjmë. Ne e vendosim, por duhet buxhet.

Këtu thuhet se janë dy mënyrat e buxhetimit: nga buxheti i shtetit dhe nga donatorët. Këtu më lind pyetja: ka faturë financiare kjo strategji? Thuhet: “2019-2023”. Po më pas, a ka faturë kjo? Në rishikimin e buxhetit të vitit 2019 thuhet: “propozohet që në draftstrategji do të fillojnë efektet e para financiare”. Po nesër? Pra, është shprehur qeveria për këtë dokument?

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj edhe kolegun Fino për sqarimet, sepse edhe indirekt mora një përgjigje për pyetjen që unë shtrova për rolin e Kuvendit.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ulsi Manja – Zoti Fino, do të vij edhe tek opozita, rri pa merak!

Vasilika Hysi – Për sa u përket pyetjeve dhe rekomandimeve që ngritën kolegu Fino dhe kryetari i Komisionit, është e vërtetë, strategjia i ka të përcaktuar qartë objektivat strategjike, politikat që duhen ndjekur, por, njëkohësisht, ka të rregulluar në mënyrë të veçantë mekanizmat e monitorimit. Ka një mekanizëm të monitorimit nga Kuvendi i Shqipërisë, që sapo e përmendëm, që është rrjeti i institucioneve. Njëkohësisht, ka një plan veprimi, i cili, sikurse e tha edhe zonja Noçka, po përgatitet me shoqërinë civile, që nuk do ta miratojë Kuvendi i Shqipërisë, sepse është detyrë e qeverisë dhe do ta miratojë Këshilli i Ministrave, ndjekjen e zbatimit sistematik të planit të veprimit, ku janë objektivat, aktivitetet konkrete, treguesit e matshëm të rezultateve, buxheti, sa nga buxheti i qeverisë, sa nga buxheti i donatorëve. Të gjitha këto do të jenë në planin e veprimit.

Edhe në dokumentin strategjik, që ka përgatitur grupi i ekspertëve të nivelit të lartë dhe grupi që ka hartuar draftin e përmirësuar të strategjisë, është kërkuar një rol aktiv i Kuvendit. Zoti Fino e ritheksoi dhe, me sa kuptova, është në favor të kësaj ideje, ngaqë janë institucione të pavarura shtetërore, shoqëri civile, medie, Kuvendi dhe gjyqësori, por njëkohësisht, në të gjitha komisionet tona të përhershme, në nënkomisione, por edhe në mekanizma mbulohen aspekte të tilla, grupi ka sugjeruar që të jetë Kuvendi. Për Kuvendin nuk ka kosto për vitin 2019. Ky rrjet nuk paguhet. Pra, është në grup me përfaqësues të institucioneve, që duhen ngritur në Kuvend, siç kemi Këshillin Kombëtar të Integritetit Europian, i cili përbëhet nga përfaqësuesit e medieve, shoqërisë civile, institucioneve, universiteteve e të tjerë. Ne kemi edhe 23 marrëveshje të lidhura me universitetet. Kemi edhe Paktin për Universitetin. Kemi disa detyrime, që na lindin në këtë kuadër.

Unë kam shtuar një paragraf te strategjia e edukimit ligjor të publikut, sepse ka disa detyrime, edhe në kuadër të marrëveshjeve të Paktit për Universitetin, ku bëjnë pjesë stazhet, praktikantët, edukimi ligjor, që do të japin universitetet, si dhe shërbimet për njerëzit në nevojë. Për Kuvendin nuk ka. Vitin tjetër Kuvendit i duhet ta krijojë këtë nuklin me stafin ekzistues, me staf ekstra apo edhe me shërbime. Është ajo që e theksoi me shumë të drejtë zoti Fino, që duhet një Sekretariat Teknik, i cili duhet ta ndjekë në mënyrë sistematike, sepse çdo 6 muaj Ministria e Drejtësisë është e detyruar të bëjë një raport, t'ia paraqesë atë Kuvendit, Kryetarit të Kuvendit dhe Komisionit të Ligjeve. Hera-herës ne mund t'u kërkojmë ministrive të raportojnë çfarë kanë bërë ose të kërkojnë përmirësime të zbatimit të strategjisë, pra në kuadër

të politikave në nivel të lartë, ndërsa në aspektin teknik nuk mund ta bëjmë. Është Ministria e Drejtësisë ajo që duhet ta ndjekë planin e veprimit dhe duhet të raportojë. Këtë e kisha merak.

Pa dyshim, EURALIUS-i ka dhënë një opinion për çështjen nëse i ka ose jo Ministria e Drejtësisë kapacitetet. Ai thotë se nuk i ka të mjaftueshme kapacitetet për ta bërë këtë, por unë mendoj se duhet ta ndajmë ne. Pra, do t'ia lëmë Kuvendit, me propozimet, siç kanë bërë në strategji dhe me atë mbështetje që tha zoti Fino, apo...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rast se ia lëmë Kuvendit...

Ulsi Manja – Po, zoti Maho.

Besnik Maho – Faleminderit, zoti Manja!

Dua të theksoj edhe një herë se nuk jemi kundër marrjes së përgjegjësisë, që Ministria e Drejtësisë të ketë barrën e marrjes së informacionit nga 30 institucione të tjera dhe më pas ta përcjellë atë te Sekretariati dhe komisioni që do të ngrihet me 12 anëtarë. Problemi është që je i barabartë mes ministrive të tjera, pushtetit lokal, KLGJ-në, KLP-në dhe institucionet e pavarura. Detyrimet, që ata të jenë pjesë e angazhimit për të përmbushur edukimin ligjor të publikut, duhet të vijnë nga instrumente ligjore, nga ligjet e tyre të posaçme dhe aktet e tjera nënligjore, në mënyrë që kur informacioni të kërkohej nga ne (se pjesa e buxhetimit dhe burimeve njerëzore është e dyta në radhë) gjithçka të jetë e bazuar në ligj, që ne jo vetëm t'i referohemi kësaj strategjie, por edhe ndryshimeve dhe instrumenteve ligjore, që ata ta kenë të mirëpërcaktuar detyrimin, që do të burojë nga kjo strategji. Sigurisht, më pas do të duhen burime, financa, në mënyrë që kjo të jetësohet, por që të jetë edhe më e detyrueshme për secilin institucion, që të mos na shohin si Perëndi, si konkurrent të Këshillit të Ministrive, duhet..

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, jemi të barabartë. Detyrimet e tyre duhet të përcaktohen nga ligjet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pikërisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta mbaroj. Dua ta elaboroj idenë.

Në mënyrë që ata të mos na shohin si të barabartë, në ligjet e tyre të posaçme, nga të cilat ata varen, ne do të shohim mundësitë e parashikimit të dispozitave, që ata ta zbatojnë këtë detyrim nga kjo strategji.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Maho!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë!

Shqetësimi që ju keni ka të bëjë me faktin nëse gjatë zbatimit të planit të veprimit do t'ju përgjigjen aktorët e tjerë, që përfshihen në këtë draftstrategji. Kjo është shumë e rëndësishme, sepse ata do ta konsiderojnë si diçka dytësore, si një ngarkesë të panevojshme.

Ajo që kërkon duhet të merret në konsideratë në këtë draft. Edhe pse thuhet se do të miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, unë mendoj se ndoshta nuk do të jetë nevoja të ndërhyhet në ligjet e tyre organike për ta pasur këtë detyrim, sepse nëse plani i veprimit miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, ky detyrim duhet të vihet në vendimin e Këshillit të Ministrave. Pra, le të themi, kur ti do t'i drejtohesh Ministrisë përgjegjëse për Infrastrukturën, në kuadrin e raportimit që do të bësh në Kuvend për planin e veprimit dhe zbatimin e strategjisë, ajo duhet të të përgjigjet menjëherë.

Besnik Maho – Detyrimin e ka nga një instrument ligjor, jo sepse....

Ulsi Manja – Shqetësimi është i saktë.

Po, zonja Meçe.

Vjollca Meçe - Desha të plotësoj në këtë drejtim. Kjo është arsyeja që në një draft të planit të veprimit që ne kemi hartuar, pika e parë e tij është rishikimi i legjislacionit. Pra, aty ku mungon, t'u vihet detyrimi institucioneve që varen nga pushteti ekzekutiv për ta bërë këtë veprimtari dhe ato pastaj t'u përgjigjen kërkesave të Ministrisë së Drejtësisë. Në fakt, ka edhe institucione të tjera, që nuk varen nga ekzekutivi dhe që do të japin kontribut. Kjo ishte arsyeja se pse strategjia doli nga Kuvendi i Shqipërisë. Kjo është edhe arsyeja pse krijohet një organ kordinues dhe mbikëqyrës, që, në fund të fundit, do të ndërhyjë gjithandej dhe do të ketë përfaqësim nga të gjitha organet, sepse janë edhe të tjera... Në përmendëm këtu Presidencën dhe sektorin akademik, që nuk varen nga ekzekutivi dhe kanë një lloj pavarësie.

Ulsi Manja – Faleminderit!

A ka dikush tjetër për të shtuar diçka?

Një konsideratë të fundit dhe pastaj do të votojmë.

Blerta Xhako – Kisha diçka, në funksion të asaj që tha kolegu. Në dijeninë time, ekzistojnë disa grupe të menaxhimit të integruar të politikave në Kryeministri, që janë të ndara në 4 fusha. Nuk e di nëse Ministria e Drejtësisë është pjesë e ndonjërës prej tyre, por në kuadër të IPMG-së, për të mos ndjerë atë diferencën midis të barabartëve, ju mund t'u kërkon "Ilogari" këtyre institucioneve. Kam përshtypjen se IPMG-ja drejtohet nga nivele shumë të larta...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, prezantohuni!

Blerta Xhako – Unë jam Blerta Xhako nga Komisioneri... Kam punuar edhe më parë dhe jam e informuar për...

Ulsi Manja – Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Blerta Xhako – Po.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, mund të vazhdoni!

Blerta Xhako – Në funksion të asaj që tha kolegu, jam informuar që ekzistojnë disa grupe të menaxhimit të integruar të politikave në Kryeministri. Planet e veprimit monitorohen në nivel teknik nga një ministri dhe më pas ajo ka të drejtën ta ngrejë në nivel më të lartë diskutimin pranë këtyre grupeve. Këto grupe, që drejtohen nga Kryeministri, kanë... Le të themi, merr atributet që mund të ketë një institucion për të ndjekur planin e veprimit dhe për të kërkuar llogari ndaj institucioneve të tjera, që janë pjesë e planit të veprimit, meqë edhe kolegu shprehu shqetësimin se nuk mund...

Ulsi Manja – Shumë faleminderit për përfshirjen në këtë diskutim, që, për mendimin tim, është i rëndësishëm!

Ky është dokumenti i parë strategjik serioz në fushën e edukimit ligjor të qytetarëve. Edhe pse kemi shumë juristë, siç tha edhe zoti Fino... Zoti Fino, e kemi debat të vjetër këtë “jurist-ekonomist”. Në fakt, ekonomistëve nuk u ka dalë zëri si juristëve. Këtu ka të drejtë zoti Fino.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne dukemi sikur jemi shumë, sepse një jurist ka 10 mendime, por nuk kemi se çfarë t’i bëjmë. Do ta pranojmë këtë fakt.

E rëndësishme është që dokument strategjik ka në fushën e edukimit ligjor, zoti Fino. Fakti që ka lindur nevoja për të pasur një dokument strategjik në fushën e edukimit ligjor, do të thotë se qytetarët kanë akoma nevojë për të pasur njohuri në fushën e ligjit.

Bashkim Fino – Jam dakord.

Ulsi Manja – Jam shumë dakord me punën e bërë, edhe me draftstrategjinë.

Nuk besoj se e teproj po të shpreh edhe një herë falënderimet e mia për kolegen Hysi, për gjithë kolegët e tjerë, që janë përfshirë me sugjerime dhe komente për përmirësimin e kësaj strategjie, për këshilltarët e komisionit, pse jo, edhe Ministrinë e Drejtësisë...!

Nuk e harroj shoqërinë civile, zyshë, pa merak! Shoqëria civile, në veçanti, ka kontribut të veçantë në hartimin e draftstrategjive të këtij lloji, sepse, në fund të fundit, janë aktorët e shoqërisë civile ata që bëjnë mbikëqyrjen dhe monitorimin më të mirë të zbatimit të këtyre draftstrategjive, pse jo, edhe të planit të veprimit, jo vetëm në fushën e edukimit ligjor, por edhe në fusha të tjera të shoqërisë.

Më vjen mirë që po shkojmë drejt fundit të miratimit të projektligjeve të paketës së dytë të reformës në drejtësi! Pas votimit të draftstrategjisë sot, na ngelen edhe dy projektligje të tjera, që do të diskutohen javës tjetër: projektligji “Për Policinë Gjyqësore” dhe projektligji “Për shërbimin përmbartimor privat”. Pastaj, me kënaqësi, Komisioni i Ligjeve do t’i japë fund miratimit të paketës së dytë të ligjeve të reformës në drejtësi, për t’i hapur rrugë zbatimit në praktikë të të gjithë paketës së ligjeve të reja të reformës në drejtësi.

E hedhim në votim.

Kush është dakord...?

Bashkim Fino – Me sugjerimet që bëmë?

Ulsi Manja – Po.

Kush është dakord me projektvendimin “Për strategjinë e edukimit ligjor të publikut në Republikën e Shqipërisë”, me sugjerimet dhe propozimet, që u bënë sot në Komisionin e Ligjeve nga kolegët deputetë, përfaqësuesit e tjerë të institucioneve dhe shoqëria civile?

Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet projektvendimi.

Relatorët dhe këshilltarët të reflektojnë sugjerimet e bëra. Të bëhet gati raporti për t’ia kaluar seancës plenare për votim të enjten tjetër, pse jo, ndoshta edhe me projektligjet e tjera të reformës në drejtësi.

Këtu e mbyllim mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme.

Shumë faleminderit!

Punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA